Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 29 TETOR 2026

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 29. OKTOBRA 2026. GODINE

TETOR - OKTOBAR
2026

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 11/L-006 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme,
6. Votimi i Propozimit të GP Lista serbe për emërimin e deputetëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Poslanička pitanja,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 11/L-013 o izmenama i dopunama Zakona br. 10/L-001 o budžetskim izdvajanjima za Budžet Republike Kosovo za 2026. godinu,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 11/L-006 o Državnom Birou za proveru i oduzimanje neopravdane imovine,
6. Glasanje o predlogu PG - Srpska lista za imenovanje poslanika u parlamentarne komisije.

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: Të nderuara deputete,
Të nderuar deputetë,
Media,
Mysafirë të pranishëm!
Para se ta nisim seancën, dua të ndalem te një çështje e rëndësishme që prek shëndetin e vajzave dhe grave në Republikën e Kosovës. Tetori, muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit po mbaron, por kujdesi për shëndetin nuk mbaron me të. Kur sëmundja zbulohet herët, shanset për shërim janë më të mëdha dhe shpesh këtë dallim e bën një kontroll që zgjat vetëm pak minuta.

Prandaj, thirrja jonë mbetet e njëjtë edhe pas tetorit, por po ashtu edhe u drejtohet të gjitha grave e vajzave kudo që ato jetojnë. Ju lutem, bëjini kontrollet me kohë dhe shkoni rregullisht te mjeku!

Sot shprehim solidaritetin tonë me gratë që po përballen këtë sëmundje dhe me familjet e tyre. Gratë që e kanë kaluar sëmundjen u japin kurajë të tjerave me shembullin e tyre.
Për institucionet, kujdesi për shëndetin e grave është detyrim i përhershëm dhe po ashtu ne do të bëjmë pjesën tonë si Kuvend i Republikës së Kosovës. Secili prej nesh mund të bëjë diçka që ky mesazh të arrijë te çdo grua dhe ta nxisë atë të kujdeset për shëndetin e saj. Le ta bëjmë, pra, bashkërisht!

Ju ftoj që këto shallet pemëve që i keni pranë ulëseve tuaja t'i vendosni, sepse për atë qëllim janë aty, si shenjë solidariteti me gratë dhe vajzat që janë të prekura nga kanceri i gjirit.

Me këtë rast, më lejoni që të ftoj deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministret e kabinetit qeveritar, por po ashtu edhe gratë që janë nga stafi i administratës së Kuvendit, që në shenjë solidariteti ta bëjmë një foto të përbashkët para nisjes së kësaj seance. Faleminderit!

* * *

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Media që po e përcillni seancën e sotme plenare,
Të nderuar të pranishëm,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Më lejoni që fillimisht të shohim sa deputetë janë në sallë, prandaj regjia, ju lutem, që të na mundësoni votimin elektronik për prezencën e deputetëve.

Votojmë tash! 82 deputetë janë të pranishëm në këtë seancë.

Ndërkohë, deputetët e tjerë po bashkohen në punimet e kësaj seance. Prandaj, i hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 26 tetor 2026.

Ju lutem që të mbani qetësi në sallë, për shkak se tashmë filluam me seancën plenare. Pika e parë e rendit të ditës është:

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,
Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet nga seancat 15 dhe 22 tetor 2026? Nëse nuk kanë vërejtje deputetët e Kuvendit, atëherë konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 15 dhe 22 tetor 2026.

Pika e radhës e rendit të ditës është:

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Prandaj, menjëherë dhe pa vonesa ftoj deputetin Adnan Rrustemi nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes që të marrë fjalën.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetare!
E nderuar kryetare e Kuvendit,
Të nderuar ministra nga Kabineti qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
Dje ka nisur punën grupi punues për hartimin e Strategjisë shtetërore për fazën e Apelit në Dhomat e Specializuara në Hagë, i drejtuar nga zëvendëskryeministri Glauk Konjufca. Për herë të parë po ndërtohet një përgjigje e organizuar shtetërore për një proces gjyqësor që ka prodhuar pasoja të rënda politike, juridike dhe njerëzore. Lëvizja Vetëvendosje kundërshtoi themelimin e Gjykatës Speciale. E kundërshtuan, sepse e kuptuan se çfarë po krijohej: një mekanizëm i veçantë gjyqësor, i ndërtuar mbi dyshime të drejtuara ndaj UÇK-së, me një juridiksion të kufizuar që e shkëputste trajtimin nga përmasat e vërteta të luftës në Kosovë.

Atëherë na thanë se kjo gjykatë do ta pastronte luftën. Sot duhet të pyesim: kush e kishte të drejtën ta vendoste luftën çlirimtare të një populli në pozitën që duhej të pastrohej prej dyshimeve? Kush kërkoi që viktimat e dikurshme të regjimit të Milosheviqit të dëshmonin përsëri legjitimitetin e rezistencës së tyre kundër këtij regjimi? Regjimi i Serbisë ishte agresori. Kosova ishte vendi i pushtuar dhe i shtypur. Shqiptarët luftuan për çlirimin e tyre. Kjo është e

vërteta historike që i paraprin çdo procesi gjyqësor dhe që nuk mund të ndryshohet nga asnjë aktgjykim.

Ndërkohë, prej vitesh, ish-drejtues të UÇK-së mbahen në paraburgim në Hagë. Vitet kalojnë, familjet presin, ndërsa procesi gjyqësor vazhdon të rëndojë mbi jetën e tyre. Një drejtësi që kërkon të jetë bindëse, duhet të jetë e tillë edhe në mënyrën si vepron, edhe në kohën që merr, edhe në standardet që zbaton. Përgjegjësia penale është individuale, por askush nuk mund të dënohet për përkatësinë e tij në një ushtri çlirimtare, për pozitën politike që ka mbajtur apo për historinë e një organizate.

Ne nuk e kemi ndryshuar qëndrimin tonë për Gjykatën Speciale. Nuk kemi harruar as mënyrën se si u themelua, as votimin e saj në Kuvend, as paralajmërimet që u shpërfillën.

Nisja e punës së grupit për strategjinë shtetërore të Apelit shënon marrjen e kësaj përgjegjësie në nivel institucional. Ajo dëshmon se Republika e Kosovës nuk mund të qëndrojë pa vepruar ndaj proceseve që tjetërsojnë historinë e çlirimit të saj.

Ne do të jemi pjesë e këtij angazhimi me bindjet që kemi mbrojtur vazhdimisht. UÇK-ja nuk ka nevojë për rehabilitim historik. Lufta e saj ishte luftë për liri. Drejtësia ka detyrime të gjykojë individët sipas provave, pa e shndërruar historinë e çlirimit në objekt të një fajësie kolektive.

Serbia duhet të ballafaqohet me gjenocidin. Sulmet e saj pas vendimit në Hagë duhet të marrin përgjigjen e duhur nga Republika jonë.

Kemi para vetes një betejë komplekse. Na nevojitet bashkërendim, bashkëpunim, bashkëveprim sot më shumë se kurrë. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar deputet Rrustemi! Vazhdojmë me deputeten Ganimete Musliu, nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

GANIMETE MUSLIU: Të nderuar deputetë,
Media,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Vrasja e Arlinda Zekajt nuk është thjesht një tragjedi familjare. Ajo është dëshmia më e dhimbshme e dështimit të sistemit tonë. Kosova sot po jeton brenda një paradoksi të rëndë juridik. Kemi një Kushtetutë që përfshin direkt Konventën e Stambollit, por kemi varre në praktikë.

Kur shteti dështon të zbatojë ligjet që vetë i ka shkruar, paaftësia institucionale shndërrohet në bashkëfajësi administrative. Të martën kërkova që drejtori i Policisë të ftohet në Komision për Çështje të Sigurisë për të raportuar lidhur me këtë rast. Anëtarët e Vetëvendosjes votuan kundër.

Unë pyes sot para jush: Nëse nuk kërkojmë llogari kur një grua humb jetën, atëherë kur duhet të kërkojmë llogari? Të kërkosh raportim, nuk do të thotë ta shpallësh dikë fajtor pa hetim. Do të thotë të kërkosh transparencë, përgjigje dhe përgjegjësi për çdo veprim apo mosveprim që mund të ketë ndikuar në këtë fatalitet.

Dhuna ndaj grave fillon shumë më herët se goditja e parë. Ajo fillon kur kontrolli quhet kujdes, kur një gruaje i kërkohet të durojë për hir të familjes, kur heshtja konsiderohet më e rëndësishme se siguria e saj.

Nuk duhet ta stigmatizojmë Kosovën si shoqëri që i urren gratë, por duhet ta themi me zë të lartë se dhunuesit nuk e përfaqësojnë kulturën tonë. Ata janë thjesht kriminelë që nuk meritojnë humanizëm.

Duhet të kemi guximin edhe ta pranojmë se ende ekzistojnë paragjykime që relativizojnë dhunën dhe e ushqejnë ndjenjën e pronësisë mbi gruan. Këto mentalitete primitive nuk duhet t'i mbrojmë në emër të traditës. Prandaj, Partia Demokratike e Kosovës sot kërkon tri veprime të prekshme dhe imediate. E para, rishikim urgjent të rasteve në rrezik të lartë. Policia, prokuroria dhe shërbimet sociale duhet të koordinohen sot për të identifikuar gratë në rrezik. Urdhri i mbrojtjes duhet të jetë siguri në praktikë, jo thjesht një dokument i vdekur në letër.

E dyta, specializimi dhe llogaridhënie radikale. Të mbash uniformën e policit nuk të bën automatikisht të aftë për të menaxhuar dhunën në familje. Brenda policisë duhet të krijohen skuadra të specializuara për vlerësimin e rrezikut. Mbi të gjitha çdo zyrtar shtetëror, polic, prokuror, gjyqtar apo punëtor social që neglizhon sinjalet e dhunës duhet të përballet me shkarkim të menjëhershëm dhe ndjekje penale, sepse neglizhenca përballë dhunës nuk është gabim procedure, është bashkëfajësi në krim.

E treta, reformë ligjore dhe buxhetore. Duhet të rishikohen dënimet për vrasje me motive të ulëta gjinore dhe të sigurohet financim i qëndrueshëm për strehimoret. Një grua që largohet nga dhuna, nuk duhet të detyrohet të zgjedhë ndërmjet sigurisë dhe mbijetesës ekonomike.

Të nderuar kolegë,
Këto kërkesa nuk janë thjesht kërkesa partiake: janë detyrime kushtetuese ndaj qytetarëve tanë. Ne do ta përsërisim kërkesën për raportim të drejtorit të Policisë dhe do të kërkojmë që kjo çështje të ndiqet institucionalisht me afate dhe rezultate të verifikueshme. Është fakt që nuk

mund ta ndryshojmë më të kaluarën e Arlindës, por mund dhe duhet ta ndryshojmë mënyrën se si shteti reagon kur një grua është në rrezik.

Na duhet reformë konkrete, jo narrativë patetike. Kosova nuk është vendi ku urrehen gratë. Kosova nuk është vendi ku urrehen vajzat. Krimi ka emër individual dhe nuk mund t'u vishet si faj kolektiv burrave shqiptarë. Për ta mbrojtur këtë vërtetë, ne duhet të bëhemi bashkë, burra e gra, pa dallim gjinor, për të garantuar zero tolerancë e për ta bërë Kosovën vendin që izolon dhe i dënon dhunuesit e jo shoqërinë që i amniston ata.

Ndryshimi i vërtetë nuk matet me numrin e fjalimeve patetike që mbajmë në këtë foltore, as me inate politike e partiake, por me jetët që arrijmë t'i mbrojmë në terren. Fjalët nuk shpëtojnë jetë. Veprimet po! Le të veprojmë sot që tragjedi të tilla të mos na përsëriten më kurrë asnjëherë.

Prandaj, në këtë luftë pa kompromis duhet të jemi bashkë, burra e gra!

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar deputete! Pajtohem plotësisht! Tani është radha e Grupit Parlamentar të LDK-së. Deputetja Albena Reshitaj, urdhëroni!

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë,
Vrasja e Arlindës na ka tronditur të gjithëve, por ajo që po dëgjojmë këto ditë e bën edhe më të rëndë, edhe më të trishtë, këtë ngjarje. Po publikohen autoincizime ku Arlinda dëgjohet duke iu lutur për ndihmë zyrtarëve policorë, ndërsa njëri prej tyre i përgjigjet: Nuk jam i obliguar të merrem me ty.

Po ashtu, është raportuar se tri ditë para vrasjes, kur Arlinda kishte thirrur policinë, zyrtarët ishin vonuar 70 minuta, sepse nuk kishin pasur veturë zyrtare në dispozicion. Unë pyes sot: çfarë sigurie mund të ndjejë një grua që kërkon ndihmë nga shteti nëse përgjigjja që merr është se askush nuk është i obliguar të merret me të?

Dhe, fatkeqësisht, kjo nuk është hera e parë që përballemi me raste të tilla. Ta kujtojmë rastin e Hamide Magashit. Një grua shtatzënë e vrarë më 30 nëntor 2022, në oborrin e QKUK-së, nga burri i saj, ndonëse kishte urdhër mbrojtjeje nga gjykata. Pas vrasjes së saj, katër zyrtarë policorë u suspenduan. Sipas raportimeve, dy hetues dyshoheshin se kishin plotësuar formularin për monitorimin e urdhrit mbrojtës vetëm pasi ajo ishte vrarë.

Më 17 mars 2023, Inspektorati Policor dorëzoi kallëzim penal ndaj tre zyrtarëve policorë, ndërsa ndaj komandantit të stacionit kërkoi procedurë disiplinore. Por, më 4 prill 2023 u ndërpre suspendimi i tyre dhe, sipas raportimit të asaj kohe, të katër zyrtarët u kthyen në punë.

Unë nuk po paragjykoj fajësinë individuale të askujt, por sot dua të di çfarë ndodhi me kallëzimin penal? A u ngrit aktakuzë? A pushuan hetimet? Çfarë ndodhi me procedurën disiplinore? Dhe, mbi të gjitha, çfarë ndryshoi konkretisht pas atij rasti? A u përmirësua monitorimi i urdhrave mbrojtës? A u forcuan mekanizmat e reagimit ndaj grave që raportojnë dhunë? Rezultatet po e thonë të kundërtën. Vetëm në 10 muajt e fundit kemi tetë vrasje.

Të nderuar kolegë,
Ditë më parë dëgjuam edhe për rastin e vajzës së mitur nga Gjilani, e cila ishte sulmuar fizikisht nga bashkëmoshatarët e saj. Sulmi ishte filmuar dhe pamjet ishin shpërndarë publikisht. Sipas raportimeve, vajza pësoi pasoja fizike dhe psikologjike, ndërsa familja ka deklaruar se nuk mori mbështetjen e nevojshme nga institucionet. Pra, familja ka deklaruar se nuk mori mbështetjen e nevojshme nga institucionet dhe në fund familja njoftoi se ishte larguar nga Kosova, ishte larguar nga ky vend për siguri, për të pasur siguri të jetës së fëmijëve të tyre. Një familje e tërë u largua nga vendi, duke deklaruar se nuk kishte marrë mbrojtjen dhe mbështetjen që i nevojitej vajzës së tyre nga shteti.

Unë pyes: Çfarë bëri shkolla për ta garantuar sigurinë e saj, çfarë mbështetje ofruan institucionet sociale dhe a është shqyrtuar seriozisht arsyeja pse kjo familje e pa largimin nga Kosova si zgjidhjen e vetme? Kemi dhe rastin e Mirjetës, gruas së zhdukur, e shumë raste të tjera, të cilat kanë mbetur në gjysmë dhe nuk kanë përfunduar.

Të nderuar kolegë,
Këto janë raste të ndryshme, por secili prej tyre na përball me të njëjtën pyetje: A po arrijnë institucionet tona t'i mbrojnë qytetarët kur ata kanë më së shumti nevojë? Sot, Qeveria po paralajmëron masa të reja për mbrojtjen e grave. Mirëpo, si e prisni që qytetarët t'ju besojnë se këto masa do të zbatohen vërtet, kur ende nuk kemi përgjigje të qarta për përgjegjësinë institucionale të rasteve të mëparshme? Besimi nuk kërkohet me fjalë boshe. Besimi fitohet me përgjegjësi dhe veprime konkrete. Nuk mjafton të miratojmë ligje e strategji nëse një grua që kërkon mbrojtje nuk e merr atë në kohë dhe kur ka nevojë. Nuk mjafton të flasim për mbrojtjen e fëmijëve nëse një vajzë e sulmuar nuk ndihet e sigurt të vazhdojë shkollimin në vendin e saj.

Prandaj, kërkoj që institucionet përgjegjëse të raportojnë para Kuvendit, para qytetarëve të Republikës së Kosovës për veprimet e ndërmarra në këto raste, për rezultatet e hetimeve dhe masat konkrete që garantojnë se lëshimet e konstatuara nuk do të përsëriten. Kjo nuk është garë politike! Kjo është përgjegjësi ndaj jetës së qytetarëve tanë. Sepse, një grua që e thërret policinë, nuk po kërkon privilegj. Një vajzë që kërkon të shkojë e sigurt në shkollë, nuk po kërkon privilegj. Po kërkon siguri, po kërkon mbrojtje, po kërkon që shteti ta kryejë detyrën e vet. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Meqë jemi te kjo temë, u lutem grupeve parlamentare që të propozoni emrat, pastaj kur të vijë radha për komisionin hetimor. Sipas rezolutës, komisioni hetimor tashmë e ka marrë mbështetjen e Kuvendit, por duhet të ketë edhe një votim në seancë me anëtarët përkatës nga grupet parlamentare që do të jenë pjesë e komisionit hetimor për këtë rast.

Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të AAK-së, ose Aleancës. Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!
I nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
E nderuara familja Zekaj,
Tragjedia e cila ndodhi para disa ditësh nga vrasja barbare, e cila e tronditi një komb, një shtet, e cila nuk po e lë rehat secilin prind që ka vajzë, secilin vëlla që ka motër, tragjedi e cila kërkon veprim të shpejtë institucional e shtetëror, përgjegjësi, hetim penal dhe mbi të gjitha përgjegjësi nga institucionet që janë në vend.
Për këtë temë kemi folur dje, pardje dhe sot nuk do të flas.

Deputetë të nderuar,
Në veçanti ju deputetë të rinj,
Dua ta sjell një çështje e cila është një ndër çështjet më etike që duhet ta trajtojmë në këtë Kuvend. Është përfitimi i ulët politik, i cili synohet të fitohet nga një tragjedi, e cila e ka goditur secilin njeri normal në këtë vend. Është e ulët që në çfarëdo rrethane, pa pasur evidencë, secili prej nesh e secili prej jush të mundohet të përfitojë politikisht nga një tragjedi, nga një trup që ende nuk ka qenë në dhe.

Këtu po ju drejtohem juve kolegë të nderuar të Lëvizjes Vetëvendosje. Po i drejtohem Taulantit. Qysh ka mundësi, Taulant, të dalësh e të lexosh fjalim në foltore e të silleni e pështjellë rreth "të fortëve" të Dukagjinit? Për çka? Pse paska dalë dikush në një foto, që e paska ngrënë dikush një drekë.

Po ju deputetë që jeni të Dukagjinit këtu, ju e dini që kur t'i hysh në konak një familje të Dukagjinit, asht e rrashtë, çka ka në shtëpi aty ta qet në sofër e do ta bëjë edhe një foto. E ne bën vaki kemi në familjet tona njerëz psikopatë. E të çohesh e ta lidhësh e me pështjellësh një njeri, një deputet, që familja e tij e njeh mirë kush është Ramush e Daut Haradinaj, Ali Berisha, se ka punuar me ta. Kjo është e ulët! Mendon që e fiton një lajm. Mirëpo, beso, personalisht ke humbur. Jam shumë i lumtur që nuk më ka dëgjuar Aleanca, partia ime, kur kam kërkuar që ty të ta japë votën për balotazh, se paskam qenë gabim.

I drejtohem koleges deputete Arjeta Fejza. Besoni, nuk mund ta dëgjoja një grua, e cila një vajzë që flet gjithë ditën për të drejtat e grave, thoshte në Parlament të Kosovës ekziston një kryeministër, dikush që akuzohet për dhunë në familje. Dhe e pyesin: kush është ai? Thotë: po është. A ka ndonjë padi? Valla kam dëgjuar në media! Po, a e di çka dëgjoj unë në media për juve? A e dini çka shoh unë në media për Xhelal Sveçlën, e kam parë me atë vrasësin e tri vrasjeve, e unë ta akuzoj Xhelal Sveçlën, ta akuzoj Albin Kurtin që e kam parë me atë Naim Murselin, që s'di a është e vërtetë, a rrenë a 'fake', e ato fermat e drogës, për t'ju akuzuar që janë me ndonjë farë familjari të lidhur, e me ia ngjit. Mos, se nuk bën kështu të bëni! Mos, se jeni duke bërë dëm substancial. Unë e kuptoj që doni ta shtyni përpara, a doni të na fusni, por nuk mund ta shtini se Dukagjini e njeh kush është Ramush e Daut Haradinaj, sikurse që e dimë që ka kriminelë, ka të pafytyrë, ka njerëz që vjen e një fotografi e bën me kryeministrin, me Albinin a me Xhelalin, a ku ta di unë me dikë, e del e thotë unë e kam, ky po më mbron e ky po më bën, e kështu me radhë.

Lërjani hetimit! Mos e helmoni! Por, në qoftë se ka dikush dhimbje për Arlindën, kemi ne që jemi bashkëluftëtarë të Ramushit, që s'po dua t'i përmend emrat! Këqyrni kush ka qenë rreth varrit të saj. Krejt njerëz që janë zyrtarë të Aleancës në Pejë e Dukagjin. A këtu paska mbetur puna e juaj? Këtu paska mbetur të fitoni vota? Mos, se ju mbulon turpi!

KRYETARJA: Vazhdojmë me Grupin Parlamentar Lista serbe, Igor Simiq.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedavajući!
Poštovani građani,
Na samom početku u ime poslanićki grupe Srpska Lista želim da kažem da mi pozdravamo rezoluciju koji je usvojen u Parlamentu kojim se osuđuje nasilje i sve ono se desilo gospodji Arlinda Zekaj i svim ženama u prethodnom periodu.

Takođe, koristimo priliku da zahtevamo odgovornost institucija koje su morale da spreče da do ovoga ne dođe, a ne samo da reaguju onda kada se pozivalo u upomoć. U tom smislu, naš predlog jeste ne samo da se deluje post festum, odnosno nakon što se desilo ovakve stvari, sigurne kuće, povećavanje kazne za ovakve zločine neće zaustaviti robno zasnovana nasilje koje trpe žene. Potrebno je raditi sa mladima koji trebaju da razumeju da su žene jednako vredne koliko i muškarci. Potrebno je preventivno delovati da ne dođemo u ovakvu situaciju koju smo došli. Kada se izvrši nasilje nad bilo kojom ženom, sigurna kuća, postupanje policije, tužilaštva, donošenje presuda, samo leče posledicu. Ne deluju preventivno i ne zaustavljaju ono što može da se desi.

U tom smislu, predlažemo da nadležne institucije sprovedu odgovarajuće postupke kroz anketni odbor ovog Parlamenta, utvrde odgovornost svih koji nisu činili svoj deo posla i doprineli su da

do ovoga dođe, kako bi se sprečilo da bilo koja devojčica ili žena doživi sličnu sudbinu kao gospođa Arljinda Zekaj. Hvala vam!

KRYETARJA: Nga Grupi Multietnik nuk po shoh që ka të paraqitur. Atëherë vazhdojmë me Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Deputeti Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: E nderuar kryetare!
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
Më 22 tetor Arlinda denoncoi se kunati i saj, Albert Sylaj, e kishte kërcënuar me vrasje. Prokuroria e trajtoi atë si dëshmitar. Tri ditë më vonë, Arlinda u vra me sëpatë. Për vrasjen e saj u arrestua pikërisht Albert Sylaj. Pas tri ditësh në arrati, Policia e Kosovës e lokalizoi. Në operacionin për kapjen e tij u angazhuan edhe njësitë speciale.

I rrethuar nga forcat policore, ai u dorëzua dhe u arrestua. Policia e gjeti pas vrasjes. Pse prokuroria nuk veproi ndaj tij kur Arlinda e denoncoi për kërcënim me vrasje? Kush vendosi ta trajtonte si dëshmitar? Me çfarë arsyetimi? Kush i kishte duart e lira të kërcënonte dhe kush ia garantonte këtë paprekshmëri? Gjykata Themelore në Pejë nxori një urdhër-mbrojtjeje që lejonte afrimin deri në 2 metra brenda shtëpisë. 2 metra!

Çfarë mbrojtjeje është kjo? Një grua e kërcënuar nga dy burra detyrohet të jetojë dy metra larg njërit, prej të cilit kërkonte mbrojtje, e asnjë metër larg tjetrit. Kjo është mizori e jo drejtësi. Avokatja e kishte paralajmëruar për rrezikun, kishte denoncuar shkeljet dhe kishte kërkuar hetim disiplinor.

Kryeprokurorja e Pejës e refuzoi kërkesën. Bëhet fjalë për dy burra me plot vepra penale. Më 25 tetor, policia e shoqëroi Arlindën në shtëpi. Pak minuta pas largimit të policëve, ajo u vra. Kush e vlerësoi rrezikun? Kush vendosi se ishte e sigurt të qëndronte aty? Pse nuk dha urdhër prokurorja të sigurohej shtëpia? Kanë kaluar tri ditë.

Këshilli Prokurorial dhe Gjyqësor duhet të zbardhin menjëherë çdo vendim, udhëzim dhe mosveprim, të identifikohen përgjegjësit dhe të nisin menjëherë procedurat përkatëse. Nuk mjafton masa disiplinore. Duhet hetim penal sa më parë, asnjë minutë më shumë. E mbështesim protestën. Revolta qytetare e atyre që protestojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Ju lutem, një minutë, regjia!

ADNAN ABRASHI: Revolta qytetare e atyre që protestojnë aktivisht dhe në heshtje është e drejtë, e domosdoshme dhe udhërrëfyese. Të mos heshtim, të dashur kolegë, të mos dorëzohemi, të luftojmë derisa të ndryshojë kjo gjendje. E kemi secili për detyrë.

KRYETARJA: Faleminderit, deputet Abrashi! Tani është radha e deputetes Eliza Hoxha nga PDK.

ELIZA HOXHA: E nderuar kryetare e Kuvendit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë,

Si duhet të jetë diplomacia kulturore dhe publike e Kosovës pas aktgjykimit të parë në Dhomat e Specializuara në Hagë? Kosova ka nevojë për një Strategji kulturore, publike dhe historike që e shpjegon luftën çlirimtare në kontekstin e saj të plotë, mbron dinjitetin e luftës për liri dhe njëkohësisht respekton drejtësinë, të drejtat e viktimave dhe pavarësinë e procesit gjyqësor.

Prandaj, Kosova në këtë drejtim mund të veprojë në dy vija paralele: në planin juridik, të mbështetur nga aspekti politik dhe financiar, gjë që u bë e mundur si vullnet politik i këtij Kuvendi përmes deklaratës së 28 shtatorit, derivat i së cilës tashmë është grupi punues ndërpartiak, i cili veç ka nisur punën në Strategjinë shtetërore lidhur me procedurat e apelit për Dhomat e Specializuara.

Dhe vija e dytë: në planin diplomatik e kulturor, është e rëndësishme të dokumentohet dhe të komunikohet historia e luftës së Kosovës, konteksti i represionit serb, karakteri çlirimtar i UÇK-së dhe rruga drejt lirisë dhe pavarësisë.

Një strategji e tillë duhet të jetë më shumë se një reagim ndaj një aktgjykimi. Duhet të jetë një investim afatgjatë në mënyrën se si Kosova e prezanton historinë, identitetin, përvojën dhe betejën e saj të gjatë për liri para krejt botës. Për gjashtë vjet të procesit në Hagë, të pakta kanë qenë aktivitetet kulturore që lidhen direkt me të vërtetën tonë historike e që kanë rrugëtuar jashtë Kosovës.

Pyetja sot është se çfarë duhet të ndryshojë në qasjen tonë diplomatike? Çfarë kemi bërë deri sot brenda dhe jashtë Kosovës? Në shumësi lidhet me diplomacinë reaktive. Shihni se çfarë bën Serbia. Sa filma për luftën në Kosovë i ka bërë Serbia? Sa para i ka shpenzuar Serbia në aktivitete diplomatike që lidhen ekskluzivisht me propagandën dhe deformimin e të vërtetës sonë historike!

Nuk them se duhet të merremi me Serbinë. Kosova duhet ta kthejë kokën nga vetja, të mundësojë më shumë aktivitete kreative cilësore që shpalosin historinë tonë në mënyra bashkëkohore të komunikimit artistik, të sigurojë apo të blejë materialet fotografike nga fotografët vendorë dhe agjencitë e huaja që kanë vepruar në Kosovë gjatë luftës në të dy anët e betejave, të rrisë fondet për hulumtime shkencore, për prodhime artistike dhe shkrime akademike për historinë e re të Kosovës, në mënyrë që vërtetësia e luftës sonë për liri të mbështetet në faktet e kohës.

Kjo mund të bëhet e formësuar në disa shtylla: në diplomacisë historike, si shpjegim i kontekstit të luftës, diplomacisë kulturore, ku historia shpaloset përmes artit. Në diplomacisë akademike, për ndërtimin e besueshmërisë. Në diplomacisë mediatike, në komunikimin e vazhdueshëm në gjuhët e aleatëve, dhe diplomacisë qytetare, në bashkëpunim me diasporën dhe qytetarët tanë.

Për të ndodhur një gjë e tillë, fillimisht ambasadat duhet të kenë atashe kulturorë, e Ministria e Kulturës të ketë strategjinë e kulturës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Regjia, ju lutem, një minutë!

ELIZA HOXHA: Përkundër një marrëveshjeje ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe MKRS-së në vitin 2020 për nevojën për atashe kulturorë nëpër ambasadat tona, pak e hiç është bërë në këtë drejtim për gjashtë vjet. Një koncept-dokument për art e kulturë, i miratuar në vitin 2022 nga kryeministri Kurti, i cili do të duhej të ishte bazamenti për strategjinë e kulturës, ende nuk ka prodhuar ndonjë rezultat në këtë drejtim.

Prandaj, sot nga kjo foltore ju ftoj që në kuadër të Strategjisë shtetërore për Dhomat e Specializuara të zgjerohet domeni i saj me aktivitete paralele që nuk e prekin apelin direkt, por krijojnë një kontekst të ri për partnerët tanë ndërkombëtarë, që ta kuptojnë në thelb kontekstin e luftës sonë për liri dhe të vërtetën tonë historike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputete! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të LDK-së, që është në radhë deputetja Janina Ymeri.

JANINA YMERI: Faleminderit, kryetare!
Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Qeverisë,
Kolegë deputetë,
Media,
Dje në Komisionin për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, e kemi pasur mysafire kryetaren e Agjencisë për Barazi Gjinore, zonjën Edi Gusia, dhe jemi dakorduar, të paktën në atë

sallë, të gjitha partitë, që buxhetet komunale të kushtëzohen përmes kodit buxhetor për banimin e gratë e dhunuara.

Është e falshme prej neve t'i kalojmë buxhetet komunale dhe në fund, përgjatë gjithë vitit, t'i lëmë gratë e dhunuara të presin se kur po shpallet thirrja, të presin banesën prej komunës në rast se ato dalin prej strehimoreve. Dje ka qenë i pranishëm nga Grupi i Vetëvendosjes, Valon Hoti, deputet, njëkohësisht e paskemi pasur edhe ministrin e Financave, Hekuran Murati, nëse dëshiron të shtojë diçka kur të përgjigjet në ndonjë pyetje parlamentare se si është procedura. Metoda se si vendoset buxheti komunal, pra për sa gra, për çfarë kohe, si dhe modalitetet nëse mund të shfrytëzohet buxheti i komunës tjetër nëse një grua dëshiron të largohet nga ajo komunë për shkak të rrezikshmërisë dhe rehatisë emocionale nuk janë diskutuar.

Andaj, mendoj se ka kohë të mjaftueshme dhe nuk mendoj se kjo duhet të kushtëzohet në baza gjinore, sepse nuk ka nevojë që vetëm gratë të mos votojnë buxhetet për të kushtëzuar votimin e përgjithshëm. Kjo çështje duhet të na bëjë bashkë të gjithëve, që asnjë komunë, nga asnjë parti, të mos ketë buxhetin e vet komunal pa e pasur edhe kodin buxhetor për gratë, varësisht nga rastet që i kanë pasur ose ndonjë formulë tjetër përcaktuese.

Gjithashtu, si pikë tjetër shtesë, meqenëse e paskam edhe një minutë, dhe që është ankesë e përgjithshme është që kapacitetet e policisë janë shumë të vogla për t'i ruajtur gratë pas 48 orëve të mbajtjes së burrave dhunues. Pra, edhe pse nuk po parashihet me ligj, ne po e nxjerrim gruan në vend të burrit, ndërsa burri po endet i lirë, e policia nuk ka kapacitete ekzistuese deri më tani për t'i ruajtur gratë për shërbime shëndetësore, për çerdhe e për shkolla, kur ne veç po ia japim lirinë dhunuesit, ndërsa për gratë po e bëjmë si sorkadhe në një formë ose tjetër, që në frikë e sipër po e pres që kur po i afrohet dhunuesi.

Kjo mbetet për t'u parë, kapacitetet e policisë, format, aktvendimet gjyqësore që nuk po hyjnë në atë pjesë. Mirëpo, ajo çfarë mund të bëjmë ne është kushtëzimi i buxheteve komunale, normalisht me miratimin e të gjithë deputetëve që janë në sallë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, e nderuar deputete! Vazhdojmë me Aleancën, që është deputetja Time Kadrjiaj. Urdhëroni, deputete!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetare e Kuvendit! Sot po e ngre një shqetësim serioz që prek drejtpërdrejt prodhimin vendor, fermerët, punëtorët dhe ekonominë e Kosovës.

Si është e mundur që prodhuesve vendorë të qumështit t'u kufizohet përdorimi i vajit të palmës në nënproduktet e qumështit, ndërsa në tregun e Kosovës vazhdojnë të shiten produkte të importuara që dyshohet se përmbajnë të njëjtin përbërës? Nuk mund të ketë një standard për

qumështin e Kosovës e për qumështoret e Kosovës dhe një tjetër për produktet që vijnë nga jashtë.

Përderisa produktet e importuara konkurrojnë në tregun tonë, qumështoret vendore po përballen me pasiguri, kosto dhe rrezik për vazhdimin e veprimtarisë. Sipas shqetësimeve të ngritura nga sektori privat, rreth 15 qumështore vendore janë në rrezik serioz. Qumështorja "Vita" ka paralajmëruar pasoja të rënda në punësim, me rrezikun që rreth 500 punëtorë të mbeten pa punë.

A e kuptojnë institucionet se çfarë do të thotë kjo? Pas çdo qumështoreje janë fermerët që prodhojnë qumësht, familjet që jetojnë nga puna e tyre, punëtorët që sigurojnë bukën e gojës dhe investimet që janë ndërtuar ndër vite. Nëse mbyllen qumështoret, kush do t'ua blejë qumështin fermerëve tanë, kush do t'i mbajë punëtorët në punë dhe kush do ta paguajë faturën ekonomike të kësaj gjendjeje?

Të sqarohet para Kuvendit, nëse produktet e importuara me përbërës të tillë trajtohen sipas të njëjtave rregulla si produktet vendore. Nëse ka dallime, ato duhet të arsyetohen ligjërisht dhe me fakte. Të ndërmerren masa urgjente për mbrojtjen e prodhimit vendor, fermerëve dhe vendeve të punës, pa e cenuar sigurinë ushqimore dhe të drejtën e konsumatorëve për informim.

Ministria dhe AVUK duhet t'u përmbahen këtyre kërkesave dhe ta trajtojnë me seriozitet këtë çështje.

Kuvendi duhet të kërkojë përgjegjësi dhe transparencë para se të rrezikohen edhe më shumë qumështoret dhe vendet e punës. Nuk bën një standard të dyfishtë. Një standard për të gjithë! Drejtësi për prodhuesit vendorë, mbrojtje për fermerët dhe punëtorët e Kosovës. Ju më parë keni rrëzuar kamionët që kanë ardhur me produkte jashtë Kosovës, ndërsa sot qëllimisht po i trajtoni këto në kushte dhe në standarde të njëjta.

Unë dua të bëj një krahasim, kush është që ta përdorim jogurtin "Vita" apo "Moja Kravica" që i kanë mbushur tregjet e Kosovës? Barazi për fermerët tanë! Barazi, sepse nuk mund të përdoren standarde të dyfishta, të lejojmë të futen dhe të eksportohen jogurtë nga Serbia, ndërsa t'ia ndalojmë punën qumështoreve tona dhe fabrikës "Vita". Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Para se të kalojmë te një deputet tjetër, vetëm do të doja që ta adresoj shqetësimin lidhur me pirjen e duhanit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Unë nuk po mund të funksionoj as vetë këtu si kryetare e Kuvendit, sepse deri këtu po mbërrin era e duhanit.

Kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta respektojnë ligjin që e ka miratuar ky Kuvend, që në ambientet e mbyllura të Kuvendit të mos pihet duhan. Përndryshe, do

të detyrohemi menjëherë që të kërkojmë nga Inspektorati që të vijë në ambientet e Kuvendit dhe të marrin gjoba deputetët të cilët e shkelin ligjin në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Është thirrja e fundit, prandaj ju lutem që ta keni parasysh këtë, sepse kjo realisht e cenon zbatimin e barabartë të ligjit, sepse nëse ne kërkojmë nga dikush tjetër ta zbatojë ligjin, do të duhej të ishim vetë shembulli i parë se zbatohet ligji që miratohet nga ky Kuvend. Është thirrja e fundi, dhe në qoftë se edhe kjo thirrje nuk respektohet, do të kërkoj nga Inspektorati të vijë dhe të ndërmarrë veprime në përputhje me përgjegjësitë.

Vazhdojmë me deputetët e tjerë sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Fridon Lala, nga Grupi Multietnik.

FRIDON LALA: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,
Të dashur qytetarë të Kosovës,
Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka hapur thirrjet për pesë skema të bursave studentore, në mes të cilave edhe thirrjen për bursa për studentët egjiptianë, ashkalinj dhe romë, në vlerë prej 1 mijë eurosh.

Kjo thirrje vjen pas nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, gjegjësisht ministrit Krasniqi dhe Çeku, si vazhdimësi e suksesshme e programit katërvjeçar të bursave nga marrëveshjet paraprake gjatë Qeverisë Kurti 2.

I inkurajojmë të gjithë studentët nga këto tri komunitete që janë të regjistruar për herë të parë në vitin e parë akademik 2026-2027 në nivelin bachelor në njërin nga universitetet publike në vend, ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të aplikojnë. Sa u përket studentëve të cilët vazhdojnë studimet në vite të tjera akademike, i njoftojmë se marrëveshja po rishikohet dhe do të plotësohet, në mënyrë që nga viti tjetër të jetë më gjithëpërfshirëse.

Mirëpo, deri atëherë, studentët e vitit të dytë, të tretë, të katërt dhe ata të nivelit master mund ta shfrytëzojnë të drejtën dhe të aplikojnë për bursë elitare, e cila po ashtu favorizon këto komunitete me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së përfshirjes së tyre në arsimin e lartë.

Po ashtu, kjo ministri sapo ka mbyllur thirrjen publike për bursa për nxënësit e shkollave të mesme nga radhët e këtyre komuniteteve, dhe vlen të theksohet se gjatë mandatit tonë 2021-2025 vlera e bursës dhe numri i përfituesve kanë shënuar rritje.

Dhe, në fund, për të përmbyllur ciklin e plotë të mbështetjes institucionale për secilin nivel arsimor, në javën që e lamë pas, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për projektet e OJQ-ve që mbështesin dhe promovojnë nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë në qendrat mësimore, nënshkroi kontrata me 10 organizata përfituese të cilat menaxhojnë 54 qendra mësimore me rreth 2 600 nxënës, në vlerë prej 370 mijë eurosh.

Mbështetja e shumëkërkuar për këto qendra filloi të zbatohej për herë të parë gjatë Qeverisë Kurti 2, përkatësisht në vitin 2021, duke u mundësuar qendrave ofrimin e shërbimeve mbështetëse për nxënësit e këtyre komuniteteve në përputhje gjithmonë me prioritetet e ministrisë për avancimin e barazisë, përfshirjes dhe cilësisë në arsim.

Ne ngelemi të përkushtuar që të angazhohemi dhe të kontribuojmë në programe konkrete për përmirësimin dhe rritjen e pjesëmarrjes në arsim dhe jo vetëm, ngase shumë shpejt do të kemi para nesh edhe projektbuxhetin për vitin 2027, nga i cili presim mbështetje qeveritare përmes investimeve kapitale dhe projekteve konkrete që ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së grupeve në nevojë. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me deputeten Edona Llalloshi.

EDONA LLALLOSHI: E nderuar kryetare e Kuvendit, zonja Haxhiu,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Media,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Vrasja e Arlindës duhet të na shërbejë si pikë kthese dhe moment kur, përtej dallimeve politike që mund të kemi pozitë dhe opozitë, duhet të bashkohemi kundër atyre burrave që e kanë kthyer dhunën në mjet sundimi, “o do të më nënshtrohesh, o do të vdesësh”.

E kush, nëse jo unë, ka arsye të flas për këtë plagë? Në vitin 2008, kushërira ime, mjekja e respektuar, Igballe Llalloshi, u vra nga bashkëshorti i saj. Edhe pse kanë kaluar 18 vite, për ne dhimbja nuk është shuar kurrë. Që nga paslufta, më shumë se 80 gra janë vrarë në Kosovë. Pas secilit prej këtyre numrave qëndron një jetë e shuar, një familje e shkatërruar dhe fëmijë që mbetën me plagë për gjithë jetën. Dhe, sot duhet ta shtrojmë një pyetje: edhe sa gra duhet të humbin jetën që ne të reagojmë me seriozitet? Andaj, të mos presim një tjetër tragjedi dhe koha është të veprojmë tani me vendosmëri, dhe ta kthejmë dhimbjen në veprim dhe fjalët në përgjegjësi.

Në 38 komunat e Kosovës funksionojnë qendrat për punë sociale. Shumica prej tyre nuk kanë personel të mjaftueshëm, profesionistë të specializuar, kushte të përshtatshme dhe sigurinë e

nevojshme për punonjësit dhe qytetarët. Duhet ta shtrojmë hapur një pyetje: a ka qenë vendim i drejtë decentralizimi i shërbimeve sociale dhe bartja e përgjegjësisë te komunat pa garantuar kapacitete dhe burime të nevojshme?

Rasti i fundit dhe mijëra raste të dhunës, të heshtura e të padukshme, që nuk arrijnë asnjëherë në vëmendjen e mediave apo në këtë sallë të Kuvendit, na tregojnë se sistemi i shërbimeve sociale ka nevojë për reformim rrënjësor. Nuk mund të presim që tragjeditë të bëhen publike për t'i kuptuar përmasat e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Një minutë, ju lutem, regjia!

EDONA LLALLOSHI: Nuk mund të presim që tragjeditë të bëhen publike për t'i kuptuar përmasat e dhunës, dhe përgjegjësinë e institucioneve për t'i parandaluar ato. Reforma e qendrave për punë sociale duhet të nisë tani. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! E fundit për fjalë është deputetja Besa Kabashi-Ramaj, për shkak se po mbaron koha e deklarimeve jashtë rendit të ditës.

BESA KABASHI-RAMAJ: E nderuar kryetare,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Një shtet që nuk arrin t'i mbrojë gratë e veta, nuk mund të pretendojë se ka garantuar sigurinë e qytetarëve të tij. Arlinda Zekaj kërkoi ndihmë, paralajmëroi se jeta e saj ishte në rrezik, iu drejtua institucioneve të Republikës së Kosovës. Sot, Arlinda nuk është më me ne.

Si është e mundur që një grua t'i drejtohet shtetit për mbrojtje, e megjithatë të përfundojë e vrarë?

Zoti kryeministër, që sot fatkeqësisht nuk je këtu! Sot kalojnë 72 orë që ju vetë i kërkuat për llogaridhënie, e nëse sot nuk kemi raport të plotë, përgjegjësi të identifikuara me masa konkrete, madje edhe përgjegjësi penale për personat përgjegjës për rrezikimin dhe vdekjen e Arlindës, çfarë vlere ka fjala e një kryeministri? Më e pakta që sot mund të bëni është shkarkimi i detyrueshëm i ministres së Drejtësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme, sepse ministrat nuk janë aty vetëm për të drejtuar institucionet kur gjithçka shkon mirë, janë aty për të mbajtur përgjegjësi edhe kur sistemi dështon.

Për më shumë se pesë vjet në pushtet, Qeveria juaj ka pasur kohën, autoritetin dhe përgjegjësinë për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes, për të siguruar policë të trajnuar, institucione të

koordinuara dhe me kapacitete, dhe reagim profesional ndaj grave të rrezikuara. Sa gra të tjera duhet të vriten që kjo të mos trajtohet më veç si një tragjedi e radhës?

Unë kam folur në Kuvendin tonë për sigurinë kombëtare, për mbrojtjen e vendit, për kërcënimet ndaj shtetit tonë, por sot duhet ta ritheksoj: siguria e grave dhe vajzave është çështje e sigurisë kombëtare, sepse siguria kombëtare nuk fillon vetëm në kufijtë tanë, fillon në shtëpitë tona, në rrugët tona, në të drejtën e çdo vajze për t'u rritur pa frikë dhe të çdo gruaje për të jetuar e lirë.

Nuk mund të ndërtojmë një Kosovë të fortë, të lirë e të begatë përderisa gjysma e popullsisë sonë duhet të jetojë me frikën se shteti mund të mos jetë aty kur ajo ka më së shumti nevojë. Ne kemi luftuar shumë për lirinë e këtij vendi, por çfarë kuptimi ka liria e një shteti nëse gratë e tij nuk mund të jetojnë të lira?

Fatkeqësisht, Arlindës nuk mund t'ia kthejmë jetën, por ia kemi borxh drejtësinë; dhe grave që sot jetojnë nën kërcënim, ua kemi borxh mbrojtjen. Zoti kryeministër, pushteti është i përkohshëm, por përgjegjësia për jetën e qytetarëve është e panegociueshme. Të mos kërkoni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe 30 sekonda, deputetes!

BESA KABASHI-RAMAJ: Të mos kërkoni më kohë për të shpjeguar dështimet, merrni përgjegjësinë për t'i korrigjuar ato, sepse një shtet që nuk i mbron gratë dhe vajzat e veta, ende nuk e ka përmbushur premtimin e lirisë së tij. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Mbaroi koha e deputetëve te deklarimet jashtë rendit të ditës. Është radha e Qeverisë, e ministrave, nëse dëshirojnë që të ngrenë çështje në raport me deklarimet e deputetëve ose çështje të tjera nga fushëveprimtaria e tyre brenda kohës që e kanë në dispozicion. Nuk po shoh që ministrat dëshirojnë ta marrin fjalën.

Le ta shfrytëzojnë këtë hapësirë edhe për sqarime që lidhen me fjalët e deputetëve, nëse jo sot, herëve të tjera, sepse ky është qëllimi i kësaj pike.

Vazhdojmë me çështjen që e përmenda te komisioni hetimor. Neve na duhet një votim për përfshirjen e kësaj pike në rendin e sotëm të ditës.

Në fakt, shefja e grupit, znj. Nagavci, e ka propozuar para disa ditëve kërkesën, e ka parashtruar dhe e ka protokolluar kërkesën për komision hetimor, pra për rastin e të ndjerës Arlinda Zekaj, një rast tragjik, që Komisioni hetimor të hetojë gjithë zinxhirin institucional dhe të nxjerrë në pah

mungesën e përgjegjësive, veprimeve të gabuara ose mosveprimeve nga ana e zyrtarëve që kanë qenë të përfshirë në këtë rast.

Prandaj, po e kaloj fjalën te znj. Nagavci shpejt që ta arsyetojë këtë propozim, që të futet në rend dite, pastaj të votojmë për shmangie dhe pastaj ta votojmë komisionin. Urdhëroni, znj. Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Ashtu sikurse e përmendët edhe ju, pra ditën e hënë, krahas miratimit të rezolutës që e bëmë këtu në Kuvend, ne kemi dorëzuar edhe kërkesën formale për krijimin e Komisionit hetimor për të hetuar të gjithë përgjegjësit për veprim ose mosveprim në raport me rastin e të ndjerës tashmë Arlindës, një shqetësim dhe brengë që po e adresojmë të gjithë bashkërisht edhe këtu në Kuvend.

Duke pasur parasysh se koha është e kufizuar, duhet të veprohet sa më parë. Duke pasur parasysh edhe mandatin e Kuvendit, gjegjësisht se një hetim i tillë dhe propozimi i masave mund të bëhet vetëm nga ana e këtij Komisioni hetimor parlamentar.

Mbi të gjitha, ne propozojmë që të vendoset sot si pikë e veçantë miratimi i këtij komisioni, në mënyrë që të mund të fillojë punën sa më parë, që nesër e jo më larg.

Ndërkohë, duhet sqaruar edhe një gjë: ndonëse sipas Ligjit për hetimin parlamentar, mandati i komisionit mund të jetë deri në gjashtë muaj, nuk ka asnjë arsye që të pritet përfundimi i kësaj kohe, edhe kërkojmë nga komisioni që të veprojë me efikasitet dhe me shpejtësinë maksimale të nevojshme, krahas trajtimit me profesionalizëm të çështjeve, të cilat i kemi parashtruar edhe në shkresën formale të dorëzuar.

KRYETARJA: Faleminderit! Nëse grupet parlamentare nuk kanë për të shtuar, çështja është vetëm për ta futur në rend dite këtë kërkesë, pra kërkesën për themelimin e Komisionit hetimor parlamentar për veprimet dhe mosveprimet institucionale lidhur me vrasjen e Arlinda Zekës dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje. Pra, komision ky që del nga rezoluta e miratuar në Kuvendin e Republikës.

Prandaj, regjia, ju lutem, të na mundësoni votimin për përfshirjen në rend të ditës. Votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj se kjo pikë e rendit të ditës përfshihet në seancën e radhës, në fakt, në rendin e ditës të seancës së sotme.

3. Pyetjet parlamentare

Te pyetjet parlamentare, më lejoni t'ju njoftoj se janë disa ministra që kanë njoftuar se për shkak të agjendës e kanë pasur të pamundur që të vijnë. Ndërsa, për ministrat e tjerë që nuk kanë njoftuar, natyrisht që do t'u tërheqim vërejtjen publike.

Ministrat e ka obligim, Qeveria e ka obligim të vijë dhe t'i përgjigjet pyetjeve të deputetëve. Unë kam kërkuar në vazhdimësi që në rastet kur ka diçka që e pamundëson që të vijë dhe t'u përgjigjet deputetëve, të njoftohemi, por gjatë kësaj kohe kemi pasur raste kur s'jemi njoftuar për mungesën e tyre në seancat e Kuvendit.

Prandaj, për secilin ministër që nuk ka njoftuar për mungesën e tij, do t'i tërheq vërejtjen publike me thirrjen që në seancën e ardhshme të vijë dhe t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve. Vazhdojmë!

E ftoj deputetin Burim Ramadani që ka parashtruar pyetje për ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zonja kryetare!
Zoti ministër,
Duke qenë se keni folur për domosdoshmërinë e miratimit të Ligjit për industrinë e mbrojtjes dhe është e qartë se ekzistojnë vonesa në krijimin e kornizës ligjore për këtë sektor, cili është afati konkret për përfundimin e kësaj kornize? Çfarë buxheti parashihet për zhvillimin e prodhimit vendor të pajisjeve të mbrojtjes? Cilat standarde do të zbatohen për kontrollin e cilësisë? Si do të garantohet transparenca në kontratat me prodhuesit vendorë dhe të huaj? Rrjedhimisht, pyetja bazike është: Pse ky proces është vonuar kaq shumë, kush e mban përgjegjësinë politike për këtë vonesë? Faleminderit!

KRYETARJA: Urdhëro, ministër Maqedonci!

MINISTRI EJUP MAQEDONCI: E nderuar kryetare e Kuvendit!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të kabinetit qeveritar,
Sa i përket pyetjes parlamentare të ngritur nga deputeti Ramadani, ju njoftoj se i gjithë procesi rreth koncept-dokumentit për industrinë e mbrojtjes është duke u zhvilluar në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara për hartimin e dokumenteve strategjike.

Para se të hartohet normalisht ligji, fillimisht është dashur të hartojmë koncept-dokumentin për industrinë e mbrojtjes. Prandaj, më dt. 15 prill 2026 kemi themeluar grupin punues

ndërinstitucional, i cili ka përfshirë 11 institucione që preken nga ky koncept-dokument. Grupi punues e ka draftuar draftin e parë dhe e ka përfunduar më 27 gusht 2026.

Pas konsultimeve paraprake ndërministrore, përfshirjes së komenteve dhe përkthimit në gjuhët zyrtare, dokumenti nga data 5 shtator deri më datën 23 tetor ka qenë në konsultim publik, ku secili ka pasur mundësi të japë komentet e tij. Pas konsultimit publik janë përfshirë komentet e nevojshme dhe dokumenti final është përfunduar këtë javë. Nga java e ardhshme ne do ta përcjellim në Qeveri për miratim dhe më pas do ta sjellim në Kuvend brenda këtij viti, në mënyrë që t'i hapet rrugë që qysh në fillim të vitit të ardhshëm, në janar, të miratohet Ligji për industrinë e mbrojtjes.

Ndërsa, sa i përket kontrollit të cilësisë, mbështetet normalisht në standardet e NATO-s dhe të BE-së, si dhe në Kornizën kombëtare për standardizim, akreditim dhe kërkesa teknike. Përmbushja e këtyre standardeve do të mbikëqyret nga një agjenci që është adresuar në këtë koncept, që është Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, përmes një departamenti të saj, e që është Departamenti për Standarde dhe Cilësi, të cilat do të menaxhojnë laboratorët e konformitetit, certifikimin e proceseve të prodhimit dhe testimit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të tregut.

Sa i përket Ligjit për industrinë e mbrojtjes, pra planifikojmë ta përfundojmë qysh në fillim të vitit të ardhshëm. Modelet që i kemi marrë për këtë ligj, modeleve të cilave u jemi referuar, elementet e tyre normalisht, sepse i kemi përshtatur për nevojat dhe aspektin e Kosovës, janë nga Kroacia, Estonia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Sllovenia, Turqia dhe Shqipëria. Gjithashtu, gjatë procesit të draftimit të koncept-dokumentit kemi pasur mbështetjen e Odës Ekonomike Amerikane dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Arsyet e vonesave....

KRYETARJA: Ministër, nuk mund ta zgjasim. Ta jap mundësinë tash kur të adresohen pyetje shtesë. Më falni se është strikte koha e pyetjeve parlamentare. Urdhëro, Burim!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetare!
Faleminderit, ministër!
E kam parë draftin e koncept-dokumentin dhe normalisht që i kam analizuar ato. Së pari, mendoj se është tepër me rëndësi të thuhet se sipas këtij drafti duhen dy vjet për ta bërë kornizën ligjore. Pra t'u themi qytetarëve se sipas këtij dokumenti tuaj duhen dy vjet për ta bërë ligjin; kornizën ligjore, aktet nënligjore e të gjitha të tjera.

Pastaj, i bie se prodhimi për industrinë e mbrojtjes fillon nga fundi i vitit të dytë, pra fundi i vitit 2028 ose fillimi i vitit 2029. Po na përsëriten fatkeqësisht fjalimet e mëdha, po veprimet shumë të ngadalshme. E njëjta besoj se është edhe me fabrikën e municionit në Gjakovë, a po? Është

lëndinë atje. Edhe ju, edhe kryeministri keni thënë se në fund të vitit 2026 fillon prodhimi, por sot në fund të vitit 2026 është lëndinë edhe më tutje.

Pra, çka po dua...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Urdhëro, ministër, dy minuta! Në pyetje parlamentare gjithmonë duhet qenë konkret!

MINISTRI EJUP MAQEDONCI: Sa u përket vonesave, ne jemi të gjithë të vetëdijshëm për një periudhë dyvjeçare që e kemi kaluar në mungesë të institucioneve stabile. Po ashtu, duhet të kemi parasysh edhe një periudhë që deri në vitin 2018 ka qenë e pamundur të kemi një Ligj për industrinë e mbrojtjes, për shkak se nuk ka pasur Ministri të Mbrojtjes. Kurse, aspekti i prodhimit nuk pengohet në mungesë të këtij ligji, sepse në mungesë të Ministrisë së Mbrojtjes, më herë është adresuar çështja e prodhimit në dy ligje, një në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe tjetri në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë. Ne normalisht jemi tani duke kaluar aty ku duhet, në Ministrinë e Mbrojtjes, pra Ligjin për industrinë e mbrojtjes.

Kurse, sa i përket kompleksit industrial të prodhimit të municioneve, ne e kemi një kontratë me një kompani shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Turqisë, ku drejtues i saj është zëvendësministri i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë, dhe kemi disa afate kohore, mes tyre për të filluar prodhimin testues qysh këtë vit, pra deri në fund të këtij viti, si dhe ndërtimin e laboratorëve dhe elementeve të tjera infrastrukturore të kompleksit prodhues vitin e ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARJA: Përmbylle, urdhëro, deputet!

BURIM RAMADANI: Faleminderit! Shkurt! Për herë të parë po e dëgjoj që mungesa e këtij ligji nuk e ndal prodhimin. Pra, pse s'po prodhohet, nëse është kjo temë?

Edhe e dyta, më falni, po koncept-dokumenti në grup punues është një njeri me aktakuzë për rastin e rezervave shtetërore. Irfan Lipovica nuk është dashur të jetë në këtë grup. Është edhe ministrja këtu. Nuk është dashur! Pra, është gabim! Njerëz me aktakuzë për keqpërdorim të detyrës zyrtare të jenë në grupin për industri të mbrojtjes, fort gabim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me deputeten Ariana Musliu-Shoshi, e cila ka adresuar pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Konjufca. Unë jam njoftuar që z. Konjufca, për shkak të agjendës që e ka pasur, e ka pasur të pamundur që të jetë i

pranishëm këtu në këtë seancë dhe ka theksuar se do të përgjigjet në seancën e ardhshme ose përmes përgjigjes me shkrim.

Pra, këto janë komentet dhe çështjet që i ka adresuar ministri. Urdhëroni, deputete!

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, kryetare!
Fillimisht e ka përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese të jetë këtu. E thatë edhe ju. Nuk është hera e parë; është hera e tretë që unë ia adresoj Glauk Konjufcës pyetjen e njëjtë dhe nuk është në seancë të përgjigjet; e ka për detyrë, e ka për obligim.

Pyetja e parë që ia kam adresuar ka të bëjë me anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

KRYETARJA: Faleminderit! Tani është radha e deputetes Ganimete Musliu për ministrin Hekuran Murati. Urdhëroni, deputete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare!
Ftoj regjinë që le të merret me këtë mikrofonin tim, se ka probleme. Mu desh ta ndërroj ulësen.

Duke marrë parasysh shqetësimet e ngritura nga Sindikata e Punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës lidhur me mosrealizimin e pagës së 13-të për punëtorët e RTK-së. Pyetja ime për ministrin Hekuran Murati, që po përsëritet që nga data 13 tetor 2026, është: Pse punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës nuk e kanë realizuar pagën e 13-të dhe çfarë veprimesh konkrete do të ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës për të siguruar trajtim të barabartë të tyre me punëtorët e tjerë të sektorit publik?

KRYETARJA: Urdhëro, ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Faleminderit për pyetjen, e nderuar deputete,
Çështja e buxhetit apo pagesave të punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës i takon Radiotelevizionit të Kosovës. Pra, është entitet i veçantë juridik. Nuk është pjesë e ndarjeve buxhetore apo pjesë si organizatë buxhetore në Ligjin e buxhetit.

Për më tepër, ligji e parasheh që Kuvendi e rregullon financimin e transmetuesit publik në këtë rast të RTK-së, dhe kësisoj i takon Kuvendit që ta caktojë buxhetin. Megjithatë, në mungesë të një buxheti apo të një forme të financimit të përcaktuar nga Kuvendi, Qeveria ka vazhduar, pra ka qenë si praktikë edhe pas tre vjetëve të parapara në ligj, ka vazhduar të ndajë subvencion për Radiotelevizionin e Kosovës, në mënyrë që ata të mund të vazhdojnë operimin. Kësisoj i takon menaxhmentit të Radiotelevizionit të Kosovës të menaxhojë çështjet e brendshme që i kanë.

Qeveria ndan shumën totale si subvencion, ndërkaq RTK-ja menaxhon dhe përcakton se cila pjesë apo sa prej asaj shume shkon në paga, sa prej asaj shume shkon në shpenzime të tjera operacionale dhe sa prej asaj shume shkon edhe në investime në pajisje. Pra, kësisoj i takon menaxhmentit të RTK-së.

RTK-ja gjithashtu e ka mundësinë që të gjenerojë edhe të hyra shtesë, pra nëse ka nevojë për të hyra shtesë apo për të mbuluar shpenzime të tjera. Por, çka i takon Qeverisë, është ndarja e subvencionimit, gjë të cilën e kemi bërë tash sa vite edhe përtej asaj që e parasheh Ligji për RTK-në. Faleminderit!

KRYETARJA: Urdhëro, deputete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit!
Një pyetje shumë më konkrete e vazhdimësi e kësaj: A janë edhe punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës të barabartë me të gjithë punëtorët e tjerë të administratës publike? A i konsideroni ju? Dhe, e dyta, vendimi kur merret në Qeveri për pagën e 13-të për të gjithë punëtorët, a vlen edhe për Radiotelevizionin e Kosovës?

KRYETARJA: Urdhëro, ministër, dy minuta!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës janë punëtorët e RTK-së, të një entiteti tjetër. Ndërkaq, punëtorët e sektorit publik, apo ajo që quhen pagëmarrësit nga buxheti i shtetit, janë tjetër kategori. Vendimi i marrë në Qeveri, pra parasheh pagën e 13-të për të gjithë punonjësit që marrin pagë nga buxheti i shtetit, pra që janë në llogarinë ose në listën e pagave që ekzekutohet nga Thesari. Në këtë rast, punëtorët e RTK-së nuk janë pjesë e listës së pagave që ekzekutohet nga Thesari, sepse nuk janë organizatë buxhetore.

KRYETARJA: Deputete!

GANIMETE MUSLIU: Ministër,
Arsyetimi yt është i pavend, sepse edhe punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës paguhen prej taksave qytetare të Republikës së Kosovës, si të gjithë punëtorët e tjerë ose shërbyesit e tjerë civilë. Prandaj, është e padrejtë që të thoni se ata paguhen me para të tjera dhe jo me para të buxhetit të shtetit. Ata janë punëtorë të shtetit, vetë fakti që janë të punësuar në një televizion publik siç është Radiotelevizioni i Kosovës, dhe ju e dini shumë mirë financimin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Prandaj, është i padrejtë dhe i pabarabartë trajtimi i punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës. Meqenëse jam pjesë e komisionit parlamentar që i trajton këto çështje, unë do të merrem edhe

me menaxhmentin e Radiotelevizionit të Kosovës dhe do të kërkoj përgjegjësi dhe llogari prej tyre pse punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës diskriminohen nga paga e 13-të.

KRYETARJA: Vazhdojmë me deputeten Teuta Haxhiu, e cila ka adresuar pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

Më lejoni vetëm t'ju njoftoj që kryeministri ka njoftuar se e ka pasur të pamundur që të vijë në këtë seancë, për shkak se e ka në takim gjeneralin Alexus Grynkewich, komandant suprem i aleatëve në Evropë, por po ashtu edhe me komisionin apo delegacionin për politikë të jashtme ose të Asamblesë Parlamentare të NATO-s që kemi takuar edhe ne dje në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pra, për shkak të këtyre dy takimeve, e ka pasur të pamundur që të vijë në këtë seancë. Urdhëroni deputete.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!
Është hera e dytë që po pres për një problem, për një pyetje, domethënë rrezikimin e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030. Uroj që kryeministri të vijë në seancën tjetër dhe të na përgjigjet, jo për interesin vetëm tim, por për interesin e të gjithë qytetarëve të vendit për të mos u rrezikuar këto Lojëra që janë me interes vendor.

KRYETARJA: Faleminderit, deputete!
Vazhdojmë me deputetin Burim Ramadani, që ka adresuar pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Sipas komunikimeve me ministrin, për shkak të raportit që është i detyruar të dorëzojë për rastin tragjik të së ndjerës Arlinda Zekaj, e ka pasur të pamundur që të vijë sot dhe t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve.

Megjithatë, po ia kaloj fjalën deputetit.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetare!
Po pres kur të jetë ministri këtu. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Kryesimin e seancës po e lë nën udhëheqjen e nënkryetarit Gola. Urdhëroni z. Gola.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Ardian Gola.)

KRYESUESI: Në radhë është deputeti Eman Rahmani. Pyetje për kryeministrin Kurti. Sqarimin tashmë e dha kryetarja e Kuvendit. Është në diskrecionin tuaj, deputet, nëse dëshironi ta bëni pyetjen ose ta lini me shkrim, ose ta zhvendosni për seancën e radhës.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!
Natyrisht, është mbledhja e dytë kjo që kryeministri mungon dhe nuk përgjigjet në pyetjet parlamentare. Absolutisht që, përveç kësaj, kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar, kryeministri nuk përgjigjet ose nuk jep qasje në dokumente zyrtare tash e gjashtë muaj dhe po e shohim se ka një qasje jotransparente.

Përveç që nuk jep qasje në dokumente zyrtare që e ka obligim ligjor, nuk vjen të përgjigjet edhe në pyetjet parlamentare. Kështu që kjo është jashtëzakonisht problematike! Unë pyetjet i vazhdoj për seancën tjetër, me shpresën se do të jetë këtu dhe do të përgjigjet, për shkak se nuk është në vullnetin e tij, por e ka obligim ligjor.

KRYESUESI: Mirë, shpresa na mbetet të gjithëve. Me shumë gjasë, edhe pyetja e gjashtë është e njëjtë, a po?

Deputeti Fadil Hadergjonaj, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Shpjegimin tashmë e morëm! Edhe për pyetjen e gjashtë. OK!

EMAN RRAHMANI: Nuk e di në çfarë roli je aty, por asnjëherë s'ke asnjë arsye, as të drejtë t'i komentosh deklarimet e mia në lidhje me pyetjet parlamentare. Në qoftë se të drejtohem ty, mund të përgjigjesh, por komentet në raport me atë se çka flas unë, as në të drejtën ligjore, as në bazë të Rregullores dhe asnjë të drejtë nuk e ke. Po vazhdon në secilën seancë ta bësh këtë dhe po të paralajmëroj për herë të fundit për këtë. Pyetja vazhdohet për seancën tjetër.

KRYESUESI: Është thjesht çështje e stilit të kryesimit. Fadil Hadërgjonaj, pyetje për ministrin Xhelal Sveçla.

FADIL HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesues!
Do të thotë, po përsëritet pyetja, edhe herën e kaluar ministri s'ka ka qenë prezent. Edhe kësaj radhe nuk është prezent këtu, kështu që rezervoj të drejtën ta përsëris pyetjen kur ai do të jetë këtu.

E kuptoj mungesën e tij, e tha edhe kryetarja paraprakisht; megjithatë, do të duhej që të vijnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve të deputetëve të cilat parashtrohen. Shpresoj shumë se herën tjetër do të jetë prezent dhe ta parashtrojmë pyetjen, e cila ka të bëjë me furnizimin e Policisë së Kosovës me uniforma dhe pajisje personale mbrojtëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për mirëkuptimin, z. Hadërgjonaj! Besoj që edhe kryetarja ishte shumë specifike në arsyetimin e mungesës, për shkak të një takimi shumë të rëndësishëm që kishte.

Vazhdojmë me ministren Hykmete Bajrami. Pyetje për ministrin Dimal Basha. Profesoreshë, fjala është për ju.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!
I kam bërë dy pyetje, në fakt. Po, njërën pyetje e kam për ministrin. Është lidhur me autostradën e Gjilanit. Unë e kam lexuar pyetjen dhe nuk e kam përsëritur prapë dhe nuk e kam ditur që më thërrisni sot, por kërkoj përgjigje domethënë në atë pyetje. Çfarë ka ndodhur me realizimin? A kemi një datë konkrete, çka ka ndodhur me shkëputjet e kontratave vitin e kaluar? A janë lidhur kontrata të reja? Sa është shuma e kontratave dhe aneks-kontratave? Sa buxhet dhe cila është data finale që ju mund t'u thoni sot qytetarëve të Republikës së Kosovës se kur rruga do të lëshohet për qarkullim?

KRYESUESI: Fjala për ministrin Basha. Regjia, foltoren!

MINISTRI DIMAL BASHA: Faleminderit, e nderuar deputete!
I kam parë tri pyetje, ndjesë që s'kam qenë në seancën e kaluar për shkak të angazhimeve. Përgjigjja është kjo: gjendja aktuale në realizimin e punimeve, sa i përket realizimit fizik sipas të dhënave të menaxherëve që kanë mbikëqyrur projektin, gjendja në tetë llotet është, si vijon: Lloti 1, 95. 8%, lloti 2, 81.79%. lloti 3, 91.92%, lloti 4, 83.21%, lloti 5, 83.86%, lloti 6, 78.10%, lloti 7, 53.5% , lloti 8, 91.6% . Këto janë të dhënat e fundit. Pra, mesatarja e realizimit fizik të punimeve del që është 82.47%, kurse për të përcaktuar saktësisht kilometrat e mbetur për përfunduar nevojitet një vlerësim i gjendjes faktike.

Te shkëputja e kontratave, para ta marrë detyrën, ministria i ka njoftuar me shkrim operatorit ekonomikë të katër lloteve për shkëputjen e kontratave. Ndër arsyet kryesore që më janë paraqitur për këtë shkëputje janë mospërputhja ndërmjet projektit dhe gjendjes reale në terren, stërzgjatja e punimeve, ndryshimi i çmimeve dhe mungesa e një elaborati të kompletuar.

Pastaj, te mjetet financiare për llotin 1 janë shpenzuar 17.7 milionë euro, po ju jap shumat e përafërta. Llotin 2, 5.3 milionë euro. Llotin 3, 6.9 milionë euro. Llotin 4, 7.9 milionë euro. Llotin 5, 16.47 milionë euro. Llotin 6, 9.9 milionë euro. Llotin 7, 4.22 milionë euro. Llotin 8, 12 milionë euro. Pra, kjo është shuma totale e shpenzuar, e cila është përafërsisht 80 milionë euro, ndërsa shuma për punime shtesë është 4.15 milionë euro.

Me rëndësi janë masat e ndërmarra dhe plani konkret. Me marrjen e detyrës si ministër, jam angazhuar personalisht për sigurimin, grumbullimin dhe sistemimin e dokumentacionit të këtij projekti.

Tash e kam një dosje të këtij projekti, e cila do të na shërbejë si bazë për angazhimin e një kompanie profesionale që do të adresojë dy çështje: e para, përgatitjen e riprojektimit dhe

përgatitjen e dosjes së tenderit, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e projektit, dhe e dyta, kjo kompani duhet të bëjë vlerësimin e saktë të sasisë dhe cilësisë së punimeve të realizuara deri më tani, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë të gjendjes faktike dhe të punimeve që mbeten për t'u përfunduar. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Bajrami kërkon fjalën për pyetje shtesë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!
Ministër, prapë nuk po na e dhatë një datë të saktë se kur përfundon. Meqenëse keni marrë masa dhe keni shkëputur kontratat katër kompanive, unë konsideroj se keni për obligim t'u tregoni qytetarëve se cilat janë dëmet buxhetore që kanë shkaktuar në vonesën e realizimit të punimeve, dhe gjithashtu për penalizimet që u janë dhënë kompanive, dhe jo vetëm kompanive, por edhe zyrtarëve, menaxherëve të kontratave, sepse konsideroj se dikush ka pasur përgjegjësi aty.

Dhe ju, gjithashtu, përmendët se do ta kontraktoni një kompani për t'i bërë ato elaborate dhe për të treguar gjithçka tjetër. Nuk po e kuptoj, në qoftë se projekti është kryer me një mesatare prej 82%, tash ju duhet ta bëni vlerësimin për punët e kryera dhe gjithashtu për punët të cilat do të kryhen.

Atëherë, ju lutem edhe njëherë na shpjegoni se çfarë bën stafi...

(Ndërprerje nga regjia)

MINISTRI DIMAL BASHA:. Faleminderit, deputete!
Kështu, tash janë dy çështje. Unë është dashur ta përgatis dosjen për krejt informacionet që i kam që janë në letër jodomosdoshmërisht paraqesin realitetin në terren. Prandaj, tash me këtë dosje unë duhet të bëj angazhimin e një kompanie profesionale, potencialisht ndërkombëtare, për të ardhur e për t'i bërë analizën e dy çështjeve:

E para, sasinë dhe cilësinë e punimeve që janë bërë. Pra, cilësinë për ata që kanë përfunduar projektin, dhe sasitë nëse korrespondojnë me realitetin në terren, si dhe për mjetet që janë paguar. Nëse këto ndryshojnë, unë duhet t'i mbaj përgjegjëse secilën kompani, përfshirë edhe zyrtarët e ministrisë që na i kanë dhënë të dhënat ndryshe prej realitetit në terren. Kjo ishte e para.

Së dyti, e njëjta kompani duhet të bëjë hartimin, riprojektimin, për shkak se aty ka probleme edhe me projektin, por edhe me kontraktorët. Por, neve na duhet një palë e tretë e pavarur që e bën këtë punë dhe më tregon: "I nderuar ministër, kjo është dosja e tenderit për të vazhduar me projektin", edhe njëkohësisht analizën për punimet që janë bërë.

Unë e kuptoj që duket se po shkojmë ngadalë. Unë mendoj se duhet të marrim përgjegjësi për këto, o duhet bërë mirë tani, ose të mos e rifillojmë edhe një herë e të përfundojmë ne me të njëjtat probleme që i kemi. Pra, kjo kompani me të cilën jemi në diskutim e sipër, jua kam dërguar dosjet, ata duhet të vijnë me analizën, që besoj se është urgjente dhe kam kërkuar të bëhet shpejt, në mënyrë që të mund të vazhdojmë përpara, edhe t'i mbajmë përgjegjës dhe të vazhdojmë përpara. E njëjta kompani që e bën riprojektimin do të bëjë edhe mbikëqyrjen. Pra, ky është plani deri tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, deputetja Bajrami ka kërkuar fjalën për ta përmbyllur diskutimin.

HYKMETE BAJRAMI: Sinqerisht, ministër, po e kuptoj, sepse të gjitha rrugët, të gjitha projektet e nisura edhe sot e kësaj dite janë të papërfunduara. I ke shpenzuar 80 milionë euro, po thua që janë kryer 82% e punëve dhe po thua se do të kontraktosh kompani ndërkombëtare për ta parë cilësinë dhe sasinë e punëve të kryera? Sa punëtorë i ke, o ministër? Ti nuk e ke marrë ministrinë as prej LDK-së, as prej PDK-së, as prej Aleancës, e ke marrë prej ministrit të Lëvizjes Vetëvendosje. Që gjashtë vjet jeni në qeverisje!

Po do ta kontraktosh kompaninë ndërkombëtare për ta parë sasinë dhe cilësinë e punëve dhe për ta bërë projektimin për pjesën e mbetur? Këto punë kryhen në fillim të projektit, ministër! I ke paguar 82 milionë, e tash do ta kontrollosh cilësinë? Me të vërtet ky është dështim. Ne kërkojmë përgjegjësi. Më e mira do të ishte të hapej tender ndërkombëtar, ta sillte Qeveria ndoshta, që t'i sjellë projektet vetë.

KRYESUESI: Deputetja Jehona Lushaku-Sadriu ka pyetje për kryeministrin Kurti. Po duket që edhe deputetja nuk ka ardhur meqë kryeministri nuk ka ardhur. Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Hekuran Murati.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryesues!
Duke marrë parasysh ekzistencën e vendimeve gjyqësore, përfshirë edhe vendimet e konfirmuara nga instancat më të larta gjyqësore, përmes të cilave është njohur e drejta e përfitimit të dy pensioneve për pjesëtarët e kategorive të dala nga lufta, lind nevoja për sqarimin e praktikës së ndjekur nga Ministria e Financave në trajtimin e rasteve të tilla.

Ministër, pse Ministria e Financave vazhdon t'i detyrojë pjesëtarët e kategorive të dala nga lufta që t'u drejtohen gjykatave përmes procedurave individuale për të realizuar të drejtën e përfitimit të dy pensioneve, kur për raste të ngjashme ekzistojnë vendime gjyqësore që e kanë njohur këtë të drejtë?

KRYESUESI: Fjala për ministrin Murati. Regjia, foltoren ju lutem!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!
Megjithëse nuk jam tashmë ministri që mbulon këtë fushë, sepse kjo fushë, fusha e skemave sociale dhe pensionale ka kaluar në një tjetër ministri, pra te Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, që kryesohet nga ministri Andin Hoti, megjithatë, duke qenë se deri në fillim të këtij viti kam qenë përgjegjës edhe për këtë portofolio, po përgjigjem.

Fillimisht, nuk është Ministria e Financave ajo që i detyron qytetarët, nuk e detyron askënd. Ligji e përcakton, dhe këtu më duhet ta citoj Ligjin për financimin e skemave pensionale të financuara nga shteti, neni 16-Kufizimet në numrin e pensioneve të paguara-, thotë kësisoj: "Personat të cilët janë përfitues të cilitdo pension të skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, në asnjë rrethanë nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga ministria" Në këtë rast, bëhet fjalë për ministrinë përkatëse për skemat pensionale dhe sociale. Pra, ligji e përcakton se një person i cili merr pension nga cilado skemë e financuar nga shteti, nuk mund të përfitojë nga skemat e tjera të cilat menaxhohen nga ministria, dhe ky rregullim ligjor është praktikë dhe në linjë edhe me parimet ndërkombëtare.

Pensioni bazik social është pension jokontributiv. Pra, nuk bëhet fjalë për një skemë kontributive. ku secili ka kontribuar dhe i takon, por është pension bazik, i cili rëndon pra, të gjitha shtetet që e aplikojnë, ku bën pjesë edhe Kosova, si shtet me një pension bazik jokontributiv, ky pension jepet për ata persona që e mbushin moshën e pensionimit, mirëpo nuk kanë të ardhura të tjera.

Pensioni bazik është për persona që s'kanë të ardhura të tjera, dhe kësisoj bëhet përjashtues edhe sipas nenit 16 që sapo e citova. Pra, ligji e përcakton që kushdo që përfiton nga pensioni bazik apo pensione të tjera nga skemat e financuara nga shteti, nga po ky ligj, nuk mund të përfitojë nga pensione apo të ardhura të tjera që menaxhohen nga ministria përkatëse për skema pensionale.

KRYESUESI: Deputetja Musliu e ka kërkoi fjalën për pyetje plotësuese.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, ministër!
Ne tashmë kemi raste të konfirmuara nga gjykata, e kam potencuar edhe në pyetjen që jua kam drejtuar me shkrim, dhe kemi disa raste që mua më kanë ardhur si dokument. Pyetja pse jua kam drejtuar juve është pikërisht për arsye se thatë që keni qenë deri në janar të këtij viti, dhe duke pasur parasysh që jeni mirë i informuar në këtë drejtim, jua kam drejtuar pyetjen juve direkt, duke e ditur se tash e ka të drejtën ministri Andin Hoti.

Por, a mundemi ne, Kuvendi, Qeveria, gjykata ta bëjmë një unifikim? Sepse ligji thotë ndryshe, ministria thotë ndryshe, gjykata thotë ndryshe, e kush po vuan këtu është qytetari i Republikës së Kosovës.
KRYESUESI: Ministri Murati fjalën.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Tash, unë nuk mund t'i komentoj vendimet e gjykatave. Ato patjetër që vendimet e formës së prerë të gjykatave janë obligative dhe ministria, cilido institucion, i zbaton. Por, gjithsesi duhet të kemi parasysh se sistemi ynë nuk është sistem anglosakson, pra, sistemi ynë juridik, ku precedenti vlen për të gjitha rastet pasuese. Domethënë, në sistemin tonë çdo rast trajtohet si rast i veçantë, dhe kësisoj trajtohen edhe rastet në formë individuale.

Sa i përket asaj se a duhet të ndryshohet kjo formë, në mënyrë që të ketë një interpretim të unifikuar, unë konsideroj se patjetër që po. Pra, duhet që në kuadër të reformës pensionale të sqarohet njëherë e mirë çështja e pensioneve të dyfishta apo edhe e harmonizimit mes skemave. Patjetër që po, si Kuvend mund të bëhet, por besoj se edhe ministri i linjës tashmë e ka në plan që ta sjellë para jush edhe reformën pensionale që do ta rregullonte këtë çështje.

KRYESUESI: Deputetja kërkon minutën e fundit për të mbyllur diskutimin.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryesues!
Ministër, meqë edhe ju deklaruat që kjo mund të unifikohet, unë do të punoj tash e tutje në ministrinë e linjës, por deri atëherë i ftoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që të bëjnë kërkesa individuale, ose thjesht t'i drejtohen gjykatës individualisht, sepse shteti nuk ofron zgjidhje. Nuk ka mundësi të ofrojë zgjidhje me legjislacionin që është në fuqi.

KRYESUESI: Në radhë është deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për kryeministrin Albin Kurti. Deputetja Bajrami, nëse dëshiron, nëse jo mund ta zhvendosësh meqë arsyetimin e dha kryetarja.

HYKMETA BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!
Unë kam ngritur çështjen e humbjes potenciale të mjeteve nga Plani i Rritjes. Unë konsideroj, besoj që Qeveria, edhe pse s'po e bën publike, tashmë e ka raportin e Komisionit Evropian për vlerësimin e përmbushjes së reformave në kuadër të Agjendës për Reforma Ekonomike.

Kemi dëgjuar deklarata të ndryshme edhe nga zoti Zulfaj edhe nga kryeministri Kurti për humbjen potenciale. Njëri thotë rreth 60 milionë euro, tjetri thotë rreth 40 milionë euro. Unë edhe sot, meqë kryeministri nuk është prezent, kërkoj nga përfaqësuesit e Kabinetit qeveritar t'u tregojnë qytetarëve të Republikës së Kosovës se sa ka humbur Kosova, meqenëse 6 nga 13 reformat nuk janë përmbushur në afatin e 30 qershorit. Sa milionë euro ka humbur Kosova?

Të mos të harrojmë edhe njëherë se në mandatin e kaluar për 960 ditë ne kemi qenë nën masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian, dhe janë qindra-miliona euro projekte të humbura dhe të shtyra për shkak të moskoordinimit të duhur me aktorët e Bashkësisë Evropiane.

Atëherë, sa është shuma e mjeteve të humbura, dhe saktësisht a qëndron ajo që 6 nga 13 hapat e reformave nuk janë përmbushur, dhe a ndjeheni përgjegjësi për këtë?

KRYESUESI: Vazhdojmë me deputeten Albana Bytyqi, pyetje për Mimoza Kusari-Lilën. Nuk qenka Albana këtu. Në rregull. E zhvendosim... Ministrin e kemi këtu, ka pasur mungesë me arsyetim herën e kaluar. Kalojmë te pyetjet që parashtrohen për herë të parë. Deputeti Fadil Demaku, pyetje për zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin, Glauk Konjufca. Duket që as deputeti nuk është këtu. Më fal, të lutem, më fal!

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë,
Duke ruajtur të drejtën që pyetjen t'ia parashtroj edhe zëvendëskryeministrit kur të jetë këtu, do ta bëj të njohur çështjen për të cilën bëhet fjalë. Pra, ka të bëjë me fjalimin e tij më 20 tetor 2026 në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ku gjatë seancës për Kosovën, kur po flitej për vendimin e Gjykatës Speciale, i shpallur më 16 shtator 2026, ai pati një qasje inerte, duke e reduktuar çështjen vetëm te masa e dënimit.

Ai nuk e trajtoi në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e kredibilitetit të procesit gjyqësor, shqetësimin për paanshmërinë e tij dhe ndikimin e vendimit të Gjykatës Speciale në të vërtetën historike për luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për liri dhe pavarësi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Demaku! Në radhë është deputeti Burim Ramadani. Pra, pyetje për kryeministrin Albin Kurti.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryesues!
E kam kthyer në pyetje për përgjigje me shkrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetja për ministrin Ejup Maqedonci tashmë është konsumuar. Në radhë është deputetja Time Kadrjiaj, pyetje për ministrin Arben Vitia. Deputete, fjala është për ju.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë mbulon një territor prej rreth 152 mijë banorësh dhe është ndër spitalet më të mëdha rajonale, me 426 shtretër. Megjithatë, ky spital ka kryer zero ekzaminime me rezonancë magnetike, sepse nuk e ka këtë aparat. Pacientët e Gjakovës, Rahovecit, Deçanit dhe Junikut duhet të shkojnë në Prizren, në Prizren s'ka, në Pejë, ose në Prishtinë, ku duhet të

presin mbi tre muaj për këtë shërbim, ose duhet të shkojnë në spitalet private, ku ky shërbim ka një kosto të lartë buxhetore.

Varet prej ekzaminimit, varet për çka kërkohet, por radhët janë të gjata për të pritur në institucione publike, dhe po ashtu kanë një kosto të lartë buxhetore. Cili është plani dhe afati i ministrisë për pajisjen e Gjakovës me rezonancë magnetike, a është paraparë dhe a do të parashikohet në buxhetin që do të vijë në Kuvend për vitin 2027, por njëkohësisht edhe për qendrat e tjera rajonale për shkak se nuk e kanë këtë aparat?

KRYESUESI: Fjala për ministrin Vitia. Regjia, në foltore ju lutem!

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë,
E nderuara deputete Time Kadrjiaj,
Spitali i Gjakovës, është e vërtetë, është një nga spitalet më të rëndësishme në Republikën e Kosovës. Siç jeni në dijeni, nga dy rezonanca që kanë qenë, të dyja në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në mënyrë që t'u ofrohet shërbim më afër qytetarëve tanë, janë shtuar edhe tri të tjera, një në QKUK, por edhe dy në spitalet rajonale të Pejës dhe të Prizrenit.

Tani kemi kaluar në fazën tjetër të investimeve, ku edhe Spitali i Gjakovës, por edhe Spitali i Gjilanit dhe i Ferizajt, do të pajisen me rezonanca të reja 1.5 Tesla, duke përfshirë edhe një rezonancë të re në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me 3 Tesla.

Në kuadër të bashkëpunimit me CEB dhe EIB, tashmë është nënshkruar marrëveshja për financimin dhe sigurimin e pajisjeve mjekësore për institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor në Republikën e Kosovës. Gjatë procesit të fundit të vlerësimit të realizuar në vitin 2025, është hartuar lista e pajisjeve mjekësore të nevojshme për të gjitha institucionet përfituese.

Këtu janë marrë parasysh nevojat e identifikuara, kapacitetet ekzistuese dhe rëndësia e pajisjeve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore bashkëkohore dhe sa më afër qytetarëve të Republikës.

Sa i përket Spitalit të Përgjithshëm të Gjakovës, në këtë listë, përveç rezonancës, janë paraparë edhe furnizime me pajisje të rëndësishme për diagnostikim, trajtim dhe kujdes ndaj pacientëve, sisteme të endoskopisë, mamografi digjitale, pajisje moderne për kujdes intensiv dhe shërbime kirurgjike, e pajisje të tjera. Presim që sa më shpejt kjo marrëveshje të ratifikohet këtu në Kuvendin e Republikës, në mënyrë që menjëherë t'i fillojmë procedurat.

Po ashtu, është në fazën e fundit projekti që të fillojë transformimi komplet i hemodializës në këtë spital, përfshirë edhe shumë projekte të tjera që janë në plan të realizohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe SHSKUK për qytetarët e Gjakovës dhe rrethinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Kadrjiaj ka kërkuar fjalën për pyetje shtesë.

TIME KADRIJAJ: Kuvendi sot ishte i mbuluar me ngjyrën rozë, që është një ditë sensibilizimi me gratë që kanë kancer gjiri, por edhe me pacientë të tjerë, qoftë burra apo gra, të cilët po përballen me këto vështirësi. Nuk është e mjaftueshme që një ditë sensibilizimi të vijmë këtu në Kuvend, të vendosim shallet ngjyrë rozë dhe të përfundojë puna e deputetëve, por duhet të përfundojë edhe puna e Qeverisë për trajtimin e këtyre rasteve.

Secila grua, qoftë me kancer, apo secili pacient për ekzaminim të detajuar që u kërkohet kur kanë çfarëdolloj sëmundjeje, e kanë parësore realizimin e MRI-je apo një rezonance magnetike për qartësim, për saktësim të llojit të sëmundjes dhe për të përcaktuar diagnozën e saktë. Dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Duket që u kuptuar substanca. Fjala për ministrin Vitia, dhe pastaj në fund prapë deputetja Kadrjiaj e ka fjalën për të përmbyllur diskutimin.

MINISTRI ARBEN VITIA: E nderuar deputete Time Kadrjiaj,
Të nderuar deputetë, faleminderit edhe juve, mediave, qytetarëve për gjithë fushatën e jashtëzakonshme që kanë bërë që sa vite për "Muajin Rozë". Falë kësaj fushate dhe falë ndërgjegjësimit që po bëhet, atë që e kam përmendur edhe më herët, mbi 53.4% e grave të diagnostikuara me kancer të gjirit tash janë në fazën e parë dhe të dytë.

Natyrisht, rezonanca është një mjet shtesë. Ashtu siç thashë, janë blerë edhe dy rezonanca të cilat funksionojnë në spitalin e Pejës dhe të Prizrenit. Gjakova, Gjilani dhe Ferizaj janë në pritje. Por, duhet ta kujtojmë edhe një gjë tjetër, përveç të gjitha këtyre masave, qoftë të ndërgjegjësimit, Ministria e Shëndetësisë e ka vënë veç në zbatim programin për skriningun e kancerit të gjiri, dhe tashmë shumica e komunave kanë mamografë.

Mamografë të tjerë, tetë të tillë shumë shpejt do të instalohen edhe në komuna të tjera. Po ashtu, siç e përmenda, edhe në Spitalin e Gjakovës edhe një mamograf digjitale, i cili do t'ju mundësojë diagnostikim me kohë të gjitha grave të cilat kanë dyshime për kancerin e gjirit. E në anën tjetër, më lejoni edhe njëherë t'ju falënderoj për këtë simbolikë sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që megjithatë është mjaftueshëm e madhe për ndërgjegjësimin e grave, dhe të bëj ftesë edhe njëherë që të gjitha gratë të vetëkontrollohen, të mos lënë në asgjë asnjë shenjë, dhe të shkojnë të vizitohen sa më shpejt te mjeku familjar dhe te specialistët e tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja për të përmbyllur diskutimin.

TIME KADRIJAJ: Unë i mirëpres të gjitha këto angazhime dhe i mirëpres të gjitha ato investime që do t'i bëni nëpër spitalet rajonale, sepse në fakt, ministër, sot ka lista të gjata pritjeje të pacientëve të cilët presin për rezonancë magnetike. Ndonjëherë kemi një shpërputhje, sepse kërkohet të bëhet operimi pas tri-katër ditësh, i kërkohet të bëhet një rezonancë magnetike, dhe brenda dy-tri ditësh pacienti duhet të gjejë se ku ta bëjë, ndërsa s'ka qasje për të hyrë në listën e pritjes, por detyrohet të shkojë ta bëjë privat, dhe i kushton xhepit të varfër të qytetarëve të Kosovës. Ajo që po kërkojmë, po kërkojmë angazhim dhe maksimum realizimin e kërkesave të qytetarëve, furnizimin e institucioneve me çdo aparaturë që kërkohet, që qytetarët të kenë trajtim të dinjitetshëm shëndetësor.

KRYESUESI: Radha është për deputeten Ariana Musliu-Shoshi. Më fal, për deputeten Teuta Haxhiu! Deputetja ka pyetje për ministrin Hajrualla Çeku.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
I nderuar ministër,
Subvencionimi i teksteve shkollore për arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2026-2027. Viti shkollor ka filluar me shumë probleme, me subvencionim të teksteve mësimore, me vonesa, me probleme edhe në administrimin e gjithë procesit. Megjithatë, pyetja ime është, sa është buxheti i ndarë për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore për vitin shkollor 2026-2027?

Gjithashtu, pse nuk janë subvencionuar me tekste dhe mjete mësimore nxënësit e arsimit parauniversitar, në fakt fëmijët e arsimit parafillor ose parashkollor që janë brenda institucioneve publike.

KRYESUESI: Fjala për ministrin Çeku. Ju lutem, foltoren, regjia!

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Zonja deputete,
Shuma e subvencionimit është 15 milionë e 143 mijë e 645 euro. Klasa parafillore nuk bazohet në tekste shkollore, por në mësim përmes lojës dhe aktiviteteve praktike. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja e kërkon fjalën për pyetje shtesë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, ministër, për një përgjigje të shpejtë edhe për punët e shpejta që nuk po i kryejnë.
Është një ligj që është plotësuar e ndryshuar në mandatin tuaj, është Ligji nr. 08/L-153, i cili ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2023.

Ju si ministër dhe qeveria juaj po bëni shkelje të këtij ligji. Në këtë ligj, po e përmend për edukimin, pra në fëmijërinë e hershme, është ky ligj, neni 18, ministër, pa hyrë në nenet e tjera për të drejtën e edukimit, thotë: "Edukimi parafillor organizohet për fëmijët nga mosha pesëvjeçare dhe funksionon në kuadër të shkollave fillore"...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Mirë, deputetja do të ketë rastin edhe në përmbyllje të diskutimit, nëse dëshiron fjalë ministri. Jo!

A mund ta përsëritësh pyetjen, të lutem, megjithëse është pak jo fort precedent kjo punë? Po, se nuk e ka kuptuar ministri si duhet.

TEUTA HAXHIU: Pra, ju po bëni një shkelje ligjore. A e konsideroni që keni shkelur ligjin tash e tri vjet? Ngase jeni të obliguar për shkak se në afatet, në aktet nënligjore, ky ligj ka hyrë në fuqi, thashë, më datën 1 gusht 2023 dhe e keni shkelur nenin 18. A e konsideroni që keni bërë shkelje ligjore apo jo?

KRYESUESI: Mirë, me shpresën që është më e qartë për ministri tash.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Zonja deputete, nuk konsideroj që jemi duke e shkelur ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë. E ke fjalën për ta përmbyllur pyetjen, zonja deputete?

TEUTA HAXHIU: Atëherë, po jua rikujtoj që ju jeni shkelës të këtij ligji për tre vjet radhazi. Neni 18 thotë: "Edukimi parafillor bëhet i detyrueshëm, siç parashihet në dispozitat kalimtare".

Edhe një herë, ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 gusht të vitit 2023. Pra, ju po bëni shkelje ligjore që tre vjet shkollore: 2024-2025, 2025-2026 dhe këtë vit shkollor 2026-2027, ministër!

Papërgjegjësi totale për mbi 16 mijë fëmijë që janë në arsimin, në objektet shkollore, pra brenda institucioneve publike, po edhe 1 mijë e 400 e sa në institucionet private. Pra, ky ligj, ministër, lexoje, të obligon, sepse po bën shkelje ligjore që tre vjet, jo vetëm këtë vit shkollor. Edukim i detyrueshëm, ministër, po ta rikujtoj edhe një herë nëse ka nevojë. Pra, edukim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Veç për rikujtim, ministri Çeku është ministër më pak se një vit, jo, tre vjet!

Deputetja Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin Glauk Konjufca. Arsyetimin e dha më herët kryetarja, por e ke në diskrecionin tuaj.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Pyetja ime ka të bëjë me themelimin e Grupit Punues për hartimin e strategjisë shtetërore lidhur me procedurat e apelit në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Pyetjen e kam adresuar më 27. 10. 2026. Mbledhja e parë është mbajtur tek dje, më 2. 10. 2026. Ky grup është themeluar më 14 tetor, pra 15 ditë pas formimit ka mbajtur mbledhjen e parë. 30 ditë i ka krejt në total që të bëjë raportim për punën që ka zhvilluar gjatë 30 ditëve.

Pra, i ka edhe 15 ditë nga dita e sotme. Nuk ka as platformë, nuk ka as strategji, nuk ka as buxhet. Pra, e kanë mbajtur vetëm një takim. As çlirimtarët tanë, as historia jonë nuk jua ka borxh të bëni hajgare. Ky proces ka nevojë për hapa konkretë, e jo për grupe që ekzistojnë veç në letër.

KRYESUESI: Veç për korrektësi, deputete, a të llogaritet e konsumuar kjo pyetje? Jo, do ta përsëritësh prapë. Në rregull!

Radha është për deputeten Arjeta Fejza, pyetje për ministrin Dimal Basha.

ARJETA FEJZA: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Çështja ka të bëjë me magjistralen Prishtinë-Mitrovicë. Jemi të informuar se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është duke zhvilluar procedurat për realizimin e projektit të rrugës Smrekonicë-Mitrovicë.

Pyetja është kjo: a mund të na informoni se në cilën fazë ndodhet aktualisht ky projekt dhe cilët janë hapat e radhës drejt finalizimit dhe realizimit të tij?

KRYESUESI: Fjala për ministrin Basha.

MINISTRI DIMAL BASHA: Faleminderit, e nderuar deputete!
Lidhur me pyetjen tuaj ju njoftoj se në fund të muajit shtator kemi pasur një vizitë me udhëheqësin e Fondit Saudit për Zhvillim, zotin Almar Shad, fond ky që e bashkëfinancon këtë projekt me 12,3 milionë euro.

Në këtë takim kemi diskutuar për rrugën më të mirë përpara për realizimin e këtij projekti, dhe kjo duke marrë parasysh disa probleme serioze të mëparshme në segmentin Prishtinë-Smrekonicë. Jemi dakorduar bashkërisht që të ndodhë rishikimi i projektit për këtë segment, pra duke përfshirë edhe elaboratin e shpronësimit. Me fjalë të tjera, kur po vonohen projektet, po

ndryshon nganjëherë gjendja në terren edhe ne po sigurohemi që të bëjmë rishikim të projektit para se të fillojë realizimi i tij.

Për të dyja këto procese jemi duke punuar me intensitet në mënyrë paralele. Kemi pasur edhe një takim përcjellës online me inxhinierët e Fondit Saudit. Edhe ata janë në kërkim për të gjetur një kompani për të bërë rishikimin e këtij projekti. Menjëherë pas përfundimit të procedurave, do të fillojmë procedurat e tenderimit për fillimin e punimeve të këtij projekti.

Pra, me fjalë të tjera, jemi dakorduar që më mirë të vonohemi dy-tre muaj në rishikim e përgatitje, se dy-tre vjet në realizim.

Ndërkohë është me rëndësi të ceket se paralelisht kemi filluar me themelimin e njësisë për zbatimin e projektit dhe aktualisht jemi në fazën e rekrutimit të stafit profesional që do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen, koordinimin dhe zbatimin e tij.

Si ministri, do të sigurohemi që të gjitha përgatitjet teknike dhe administrative të kryhen në kohë, në mënyrë që me fillimin e realizimit të shmangen të gjitha pengesat dhe vonesat e mundshme në realizimin e projektit. Faleminderit!

KRYESUESI: Goxha ezauruese ishte për të mos mundur të vazhdojë me pyetje shtesë. Të faleminderit, ministër! Edhe pyetjen e fundit e kemi nga po e njëjta deputete, Arjeta Fejza, për ministrin Blerim Gashani, i cili me leje nuk është këtu.

ARJETA FEJZA: Kryesues, le të përcillet për në seancën e radhës, ju lutem!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë konsiderojmë që edhe kjo pikë e rendit të ditës përfundoi. Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026

Të nderuar deputetë,
Komisioni për Buxhet, në cilësinë e Komisionit përgjegjës raportues, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara nga Komisioni përgjegjës raportues. Komisionet e tjera parlamentare, në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre, e kanë shqyrtuar projektligjin dhe nuk kanë paraqitur ndonjë rekomandim për Komisionin përgjegjës raportues. Komisioni për Arsim dhe Shkencë nuk ka paraqitur raport. Ftoj kryetarin e Komisionit përgjegjës raportues, deputetin Enver Haliti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

ENVER HALITI: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë.
Komisioni për Buxhet, në bazë të neneve 80 dhe 81 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 tetor 2026, shqyrtoi Projektligjin nr. 11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe Kuvendit të Kosovës ia paraqet këtë rekomandim:

-Të miratohet Projektligji nr. 11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional si në vijim.

Ashtu siç e përmendët edhe ju, zoti nënkryetar, ky projektligj ka gjithsej shtatë amendamente: dy të Komisionit Funksional që kanë marrë miratimin, një të Komisionit për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Personat e Pagjetur dhe janë katër amendamente nga deputetët pa përkrahjen e komisionit.

Projektligjin e kanë shqyrtuar të gjitha komisionet parlamentare, ku kemi vetëm një amendament nga Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë dhe Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Personat e Pagjetur. Gjithashtu, më lejoni, nënkryetar, që në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje të deklaroj mbështetjen për plotësim-ndryshimin e këtij projektligji. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.)

KRYETARJA: Tani të drejtën e fjalës e kanë përfaqësuesit e komisionit, të cilët kanë propozuar amendamente. Po, urdhëron zoti Hoti. Po, e ke kërkuar fjalën?

AVDULLAH HOTI: E kam kërkuar fjalën në emër të grupit parlamentar për deklarim për këtë projektligj. A mund të vazhdoj apo? Faleminderit!

Besoj që është e nevojshme që të bëhet e qartë pse po bëhet ky rishikim. Ky rishikim ka për qëllim mbulimin e vendimit joligjor të Qeverisë për shpenzime prej 122 milionë euro në muajt e parë të këtij viti. Pra, ky është qëllimi i rishikimit të këtij ligji. Ligji i buxhetit është specifik, çdo shifër në këtë ligj është pjesë e ligjit dhe çdo shpenzim duhet të bëhet në përputhje me këtë ligj, përveç shpenzimeve të jashtëzakonshme për të cilat është e paraparë edhe baza ligjore dhe është ndarë zëri buxhetor për shpenzime të tilla.

Por, praktikisht, ju e keni shkelur ligjin dhe tani po kërkohet të amendamentohet ligji në mënyrë që të akomodohet ajo shkelje që është bërë në pjesën e parë të këtij viti. Pra, ky ligj ka dy probleme.

E para, në aspektin procedural është gabim dhe ka gjithashtu probleme përmbajtjesore. Sa i përket aspektit procedural, neni 25 i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike që lidhet me procedurat që duhet ndjekur për rishikim të buxhetit, thotë qartë: ministri mund të përgatitë rishikimin e buxhetit nëse ai ka mjaft arsye të besojë se të ardhurat janë më të ulëta sesa që janë planifikuar në ligj, shpenzimet janë më të larta sesa që janë planifikuar me ligj, ose kur Kuvendi e ndryshon një ligj, e anulon një ligj ose nxjerr një ligj të ri i cili ka implikime buxhetore.

Në të gjitha rastet, ministri duhet të konsultohet me organizatat buxhetore që preken nga çdo rishikim i buxhetit dhe duhet të përfillet plotësisht procedura siç kërkohet me nenet përkatëse, nenet 20-22 të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Çka i ka sjellë ministri Kuvendit? Një projektligj me dy faqe tekst dhe dy tabela. Cila është kërkesa e Ligjit për menaxhimin e financave publike sa i përket rishikimit të buxhetit që vjen në Kuvend? Ai thotë që ministri duhet të sjellë një tabelë që përmban informatat për politikat fiskale që shprehin të ardhurat dhe shpenzimet, një shtojcë ku sqarohen supozimet mbi të cilat parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet, edhe një shpjegim i dallimeve mes parashikimeve të reja dhe buxhetit aktual.

Asnjëra nga këto kërkesa ligjore nuk është plotësuar për këtë rishikim të buxhetit. Prandaj, kjo procedurë e rishikimit të buxhetit është joligjore. Për qartësi, duhet së pari ligji, e mandej të bëhen shpenzimet, e jo të bëhen shpenzimet e mandej të rishikohet ligji për t’i akomoduar ato shpenzime.

Dhe, problemi tjetër përmbajtjesor i ligjit: projektligji adreson tri çështje. E para, marrjen e dividendës nga ndërmarrjet publike në shumën prej 30 milionë eurosh. Unë e kam ngritur këtë çështje me ministren edhe në Komisionin për Buxhet. Nëse shihni raportin e auditimit për vitin 2025, tek pjesa e ndërmarrjeve publike, vetëm KEK-u ka deklaruar një fitim prej 10 milionë euro, ndërkaq detyrime ka 156 milionë euro, dhe KOST-i ka deklaruar fitim për vitin 2025 rreth 10 milionë, e i ka detyrime 54 milionë euro.

Të gjitha ndërmarrjet publike kanë fitime krejt josignifikante. Pra, nuk ka ku të merret kjo dividendë e paraparë prej 30 milionë euro, sepse ndërmarrjet publike, ku ju e keni ndalur gjakderdhjen financiare, kanë obligime totale prej 333 milionë euro, sipas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Çështja e dytë e adresuar në këtë projektligj lidhet me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për shkeljet ligjore të Qeverisë dhe të Kuvendit me përgjysmimin e përfitimeve nga përvoja e punës. Tash duhet t'i adresoni ato çështje.

Dhe, e treta, ndarja e 122 milionë euro për pagën e 13 dhe për pensione të paguara në pjesën e parë të vitit. Pra, ligji ka probleme procedurale, sepse u shkelën nenet përkatëse për rishikim të buxhetit në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, dhe në aspektin përmbajtjesor nuk mund të realizohet, siç është rasti te dividenda.

Në të kaluarën, kur kemi bërë rishikime, i kemi bërë me qëllim që të akomodohen projekte të mëdha kapitale, të cilat kanë pasur nevojë për buxhet shtesë, e jo amendamentime, rishikime të buxhetit për të mbuluar vendimet joligjore të marra më herët. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Hoti! Nga PDK-ja nuk pashë, prandaj kalova te LDK-ja. Nëse nuk ka dikush nga PDK-ja, atëherë kalojmë te, po urdhëroni zoti Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar kolegë deputetë, ne e kemi shqyrtuar projektligjin për ndryshimin e ndarjes buxhetore për këtë vit dhe ashtu sikur kolegët e opozitës, jemi të shqetësuar për faktin se nuk ka një ndryshim përmbajtjesor, ku i akomodon buxhetin në ndryshimet që kanë nevojë komunat e Kosovës, por edhe organizatat e tjera buxhetore, të cilat kanë ngelur për të investuar në projektet që e ndryshojnë me të vërtetë edhe jetën përmbajtjesore të qytetarëve.

Sigurisht, kur e marrim për bazë edhe ndryshimin apo pagën e 13-të, kemi pasur edhe kërkesa të tjera nga institucionet e tjera, siç është edhe transmetuesi publik i RTK-së, që nuk ka një mbështetje për këtë pjesë. Por, gjithashtu, kam ngritur edhe çështjen e pagës së 13-të, ku nëpunësi publik ndoshta e ka marrë një pagë ekstra, nëse marrim për shembull, 700€ e ka pasur pagën bazë dhe ka marrë një 700€ tjetër në fund të vitit.

Ndërsa kërkesa jonë ka qenë nga fillimi që të kemi një rritje të pagës prej 50%, që, nëse dikush e ka pasur pagën 700€, atëherë vetë rritja e kishte konsideruar që të kemi diku 4 200€ në gjithë vitin, apo në çdo muaj 350€. Prandaj, për neve ka qenë më e arsyeshme që të kemi një rritje të pagës në muaj, ku edhe qytetarët, nëpunësit publikë, do ta kishin më lehtë të përballen me çmime të larta. Dhe, prandaj, sigurisht që ne nuk do të mbështesim këtë ndryshim të ligjit. Faleminderit!

KRYETARJA: Dhe e fundit për fjalë është deputetja Haxhiu pra, nga Aleanca, Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!
Edhe grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar rishikimin e buxhetit për vitin 2026. Krejt çka kemi parë në këtë rishikim është një paaftësi e ministrit të Financave, ose më mirë të themi një

dinakëri e tij në dëm të komunave. Janë rritur të hyrat për 81,5 milionë dhe janë përjashtuar komunat nga formula për 10 milionë euro.

Pra, me këtë rishikim, komunat e Republikës së Kosovës janë dëmtuar në vlerën 10 milionë euro. Ku po shkojnë këto mjete prej 112 milionëve? Këto mjete që kanë ardhur, thashë, nga të hyrat në paga dhe në shtesa. Në paga prapë është paaftësi ose mashtrim i planifikuar, sepse nuk i keni planifikuar. Nëse s'i keni planifikuar t'i qitni pagat, çka i bie kjo? Domethënë, po të mos kishim të hyra më shumë që kanë ardhur si rezultat i ngritjes së TVSH-së në derivate e të hyra të tjera, po të mos kishim të hyra, a i bie kjo që nuk i kishit ekzekutuar pagat?

Dhe pjesa tjetër, shtesat. Pra, është gjithashtu një aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese që jua kthen për përvojën e punës, pra mosllogaritjen ose dëmtimin që ju keni bërë të gjithë atyre, për shkak se në një ligj që kemi pasur në Qeverinë Haradinaj, 0.5 është llogaritur përvoja e punës për vit, kurse ju e keni kthyer në 0,25. Gjykata Kushtetuese ua ktheu dhe ky aktgjykim jua ktheu, pra t'i ktheni retroaktiv ato. Por, i keni tejkaluar të hyrat, edhe njerëzit, po të mos kishin të hyra, i bie që kishin mbetur pa paga.

Ministër, inflacionit të ka ndihmuar që t'i tejkalosh të hyra, se jeni të dobët në planifikim, e keni dëshmuar edhe me këtë rishikim. Gjithmonë, kur planifikon jo drejt, dështimin e ke pa diskutim. Pra, edhe një herë, njerëzit po të mos ishin rritur të hyrat, a i bie që s'kishin marrë pagë të 13-të?

Domethënë, ju s'e keni planifikuar me kohë pagën e 13-të dhe a po e bëni me qëllim që po i dëmtoni komunat në çdo aspekt? Në çdo aspekt!

Në fund të fundit, qytetarët jetojnë nëpër komuna, fshatra e qytete. Shërbimet e para i marrin prej komunës. Komuna është adresa e parë. Kurse Qeveria është institucioni që duhet t'i ndihmojë qytetarit. E qytetari dëmtohet në fakt kur dëmtohet me buxhet komuna. Këtu pra duke marrë sektorin e arsimit për miliona euro që u merren komunave me të drejtë, që i marrin mësimdhënësit qoftë me përmbarues apo dhe sektorët e tjerë. Por, prapëseprapë, ju me buxhet nuk po i ndihmoni qytetarit. A janë të qëllimshme krejt këto? Ky është rishikimi i buxhetit për vitin 2026!

KRYETARJA: Edhe deputetja Bajrami është paraqitur për fjalë. Urdhëroni, deputete.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!
Unë kam pyetje konkrete për ministrin e Financave. Ministër, është krijuar opinioni, ka një diskutim të përgjithshëm nga rreth 83 mijë shërbyes civilë sa janë, që me amendamentimin e Ligjit të buxhetit ata në fund të këtij viti do ta marrin pagën e 13-të. Ndërkohë që zoti Hoti vetëm sa e shpjegoi dhe e kemi parë gjithashtu edhe ne, edhe nga dokumentacioni dhe kemi informata, që fondi për pagën e 13-të është fond të cilin ju do ta mbuloni ekzekutimin e pagës së 13-të, të

cilin e keni bërë më 31 mars të këtij viti. Dhe ne e dimë të gjithë se cili ka qenë qëllimi: më 31 mars zgjedhjet për 7 qershor kanë qenë të shpallura dhe ajo ka qenë arsyeja pse ju pa e planifikuar në buxhetin e vitit 2026 e keni ekzekutuar një pagë të 13-të.

Po çfarë po kërkoj unë sot është që ju të dilni dhe t'u tregoni qytetarëve të Republikës së Kosovës se amendamentimi i këtij ligji nuk u siguron atyre pagë të 13-të për këtë vit, domethënë për vitin 2026, sepse të gjithë tanimë kanë bërë planifikimet e tyre që më së largu me pagën e dhjetorit, ata do ta marrin edhe një pagë ekstra. Këtë konsideroj që e keni për obligim. A jeni duke mbuluar shpenzimet që i keni krijuar në kohën e fushatës, apo po planifikoni që të jepni pagë të 13-të për vitin 2026? Sepse, me sa e mbaj mend unë, paga e ekzekutuar më 31 mars iu ka atribuuar vitit 2025, e të gjithë dimë që qëllimi ka qenë blerja e votave.

KRYETARJA: Faleminderit! Ministër, a e dëshiron fjalën? Nuk ka të tjerë të paraqitur.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit!
Po mundohem që shkurtimisht t'i adresoj vetëm disa prej çështjeve që u ngritën. Rishikimi është plotësisht i ligjshëm, pra ajo kërkesa për dëgjime buxhetore është plotësuar. Ne kemi bërë rishikim në Ministrinë e Financave. Domethënë, patjetër që me vetveten jemi konsultuar para se të vijmë këtu, apo jo? Pra, nuk ka sens të thuhet që s'ka pasur konsultime apo dëgjime buxhetore për rishikim nëse ndryshimi që po bëhet është te Ministria e Financave.

Sa i përket dividendës që e ngriti çështjen deputeti Hoti, edhe kjo është e ligjshme, dhe më lejoni t'u rikujtoj që në financat e korporatave- finance corporate- është më se normale që të ketë kompani që ka edhe obligime, pra hua, dhe në të njëjtën kohë paguan dividenda. Të njëjtën situatë e kemi në Google, Apple, Microsoft. Pra, ka shumë e shumë korporata multinacionale, të cilat kanë obligime dhe hua me miliarda dollarë, por në të njëjtën kohë edhe paguajnë dividenda. Kjo ka të bëjë me mënyrën se si e menaxhojnë likuiditetin e vet ato ndërmarrje.

Pra, kjo nuk e përjashton njëra-tjetrën. Pra, fakti që një ndërmarrje mund të ketë obligime, nuk e përjashton faktin që mund të paguajë dividendë. Çka është e rëndësishme është që të ketë likuiditet, pra mjete të mjaftueshme, dhe të ketë operuar me fitim.

Por, në një situatë që më duhet t'ia rikujtoj deputetit Hoti sa ka qenë ministër i Financave është tërhequr dividendë nga Telekomi, teksa ka punuar me humbje. Pra, Telekomi ka qenë duke humbur, duke u gjakderdhur, dhe Qeveria e asaj kohe ka tërhequr dividendë, pra, vetëm sa për ta vendosur standardin e operimit.

Nga ajo që u tha nga deputetja Haxhiu, pra, po dëmtohen komunat. Është e pavërtetë. Nëse shikoni, pra, paga e 13-të dhe fondet për pagën e 13-të, nëse gjysma e stafit, e personelit që merr pagë nga buxheti i shtetit është në komuna, pra, ky buxhet u ndahet komunave për t'i shpenzuar

apo për t'i mbuluar pagën e 13-të. Në anën tjetër, është edhe përvoja e punës, pra, njësoj. Pra, të gjitha këto mjete ndahen proporcionalisht me numrin e të punësuarve, ku gjysma janë të punësuar, pra, në nivelin lokal dhe gjysma tjetër është e punësuar në nivelin qendror. Pra, gjysma e buxhetit që ju po e thoni, shumë më tepër sesa ai 10 milionëshi që po e kërkoni për komunat, u ndahet komunave në këtë rast për t'i mbuluar shpenzimet rrjedhëse.

Sa i përket çështjes së pagës së 13-të, unë e kam sqaruar edhe më herët edhe në komision: nuk mund të marr përgjegjësi nëse dikush e keqinterpreton këtë, apo e keqsqaron, përfshirë edhe deputetët ndoshta. Zonja Bajrami, çështja e pagës së 13-të: paga e 13-të ka qenë e paraparë, e keni në Ligjin e buxhetit të këtij viti. Është ligji që është miratuar në shkurt të këtij viti. Ka qenë e paraparë që për vitin 2026 të paguhet në fillim vit.

Kjo ka qenë edhe në buxhetin që e kemi dorëzuar në tetor të vitit 2025 për vitin 2026. Pra, paga e 13-të është e paraparë në buxhet dhe është paguar sivjet. Kjo që po ndodh është mbulimi i hendekut nga alokimi i parakohshëm, ashtu siç e ka paraparë Ligji i buxhetit i miratuar nga ky Kuvend.

Ndërkaq, paga e 13-të për vitin e ardhshëm paguhet në fillim të vitit të ardhshëm, ashtu siç e kemi thënë. Pra, paga e 13-të do të paguhet në fillim të secilit vit. Sa i përket asaj se pritjet që kanë krijuar qytetarët, patjetër që do të marrin shtesë. Nëse kalon ky rishikim i buxhetit, pra do të jetë përvoja retroaktive e punës që do t'u paguhet, është 0,5%, pra ajo pjesa retroaktive që nga data kur Ligji i pagave ka qenë në fuqi deri në fund të vitit 2025, sepse nga viti 2026, pra nga janari i këtij viti, tashmë është e përfshirë dhe paguhet çdo muaj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Për replika janë tre deputetë. I marrim të tre me radhë, pastaj përgjigjet e ministrit. Unë vendos a ka, sepse unë bazohem në Rregullore. Pra, as unë jo vetë, po Rregullorja që është miratuar nga ky Kuvend. Tre deputetë: Hoti, Bajrami, Mustafa. Urdhëro, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!
Ndjesë, po më duhet të flas drejtpërdrejt, ndjesë për fjalorin, por ministri po gënjen midis seancës! Kjo është e vërteta, po gënjen. Kur e kemi marrë dividendën nga Telekomi, kanë qenë mjete të grumbulluara nga vitet paraprake kur PTK-ja ka operuar me fitim. Kjo është e vërteta!

Dhe ne kemi kërkuar për herë të parë që të tërheqim dividendë nga Telekomi i Kosovës për buxhetin e shtetit, duke qenë se aksionar është shteti i Kosovës. Ministri financat e korporatave i di mirë, sepse këtë buxhetin personal e udhëheq shumë mirë, se bën investime poshtë e lart, është e drejtë e tij plotësisht, por financat e shtetit nuk po i din, edhe po abuzon me ato që i ka në dorë.

Po si mund të thotë që t'u kërkojë ndërmarrjeve publike 30 milionë, kur krejt fitimi i ndërmarrjeve publike, të gjithave së bashku, është 24 milionë për vitin 2025? Të gjithave!

Dy kryesoret, KEK-u dhe KOST-i, me nga 10 milionë. Po obligimet ato i kanë 333 milionë! Gjysma e tyre janë obligime afatshkurtra që duhet të kryhen brenda një viti, që po i lëmë obligimet afatgjata. Po gjysma e këtyre janë obligime afatshkurtra që i bie: paga, fatura të papaguara e tjerë e tjerë.

Pra, mos dil për t'i mashtruar njerëzit, deputetët e qytetarët në foltore të Kuvendit me teori të korporatave, financave të korporatave. Ti veç financat e tua personale i di, jo të shtetit. Je abuzuesi më i madh që ka pasur ndonjëherë Qeveria e Kosovës!

KRYETARJA: Deputetja Bajrami, replikë!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetare!
Ministri veç sa e konfirmoi që ky nuk di të bëjë planifikim. Tha: e kam planifikuar pagën e 13-të me buxhetin e vitit 2026, e ka ekzekutuar më 31 mars, që në asnjë vend nuk ekzekutohen paga të 13-ta në fillim të vitit, dhe gjithashtu ka ardhur me rishikim për të mbuluar koston e një page të 13-të, të cilin ai e paska pasur të planifikuar qysh në krye të herës. Domethënë, ky është keqplanifikim i planifikuar dhe nuk e di se çfarë të them për këtë më tepër.

Sa i përket shtesës për përvojën e punës, ministër, konsideroj që ju i keni borxh të gjithë punëtorëve të sektorit publik që t'i kërkoni falje, sepse që në fillim të kemi thënë që je duke bërë shkelje kushtetuese, dhe nesër kur e ekzekuton kthimin e asaj që ia keni ndalur në mënyrë jokushtetuese, ajo për shkak të inflacionit nuk e ka asnjëherë vlerën e barabartë me atë që do ta kishte sikur të ekzekutohej me kohë. Domethënë, duhet të kërkoni falje duke bërë shkelje kushtetuese, ju e keni ndalur dhe tash po e ktheni dhe po konsideroni që po bëni vepër të madhe.

Dhe tjetra, ministër, duhet t'u themi qytetarëve të Republikës së Kosovës se këto të hyra që i keni sot dhe po e keni komoditetin që t'i mbuloni kostot e paplanifikuara për blerjet e votave që i keni bërë për fushatën e 7 qershorit, janë taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës për shkak të inflacionit të lartë. Më 23 prill, ky Kuvend e ka kaluar Ligjin për kontrollin e çmimeve.

A e ka dëgjuar ndonjë qytetar i Republikës së Kosovës që ju keni ndërmarrë ndonjë masë? Përkundrazi! Ka hyrë ligji në fuqi, kurrë më çmimet tavan nuk i keni përmendur, ndërkohë që për pesë vjet sa herë është përmendur inflacioni, ju...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Deputetja Haxhiu, replikë!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!
Ministër, më e pakta një joprofesionalizëm, se për këtë e di, je i dëshmuar, por për të kërkuar falje.

Unë nuk mashtroj, ti je mashtrues! Në çdo buxhet, të cilido vit formula që ndahet për komunat nga të hyrat, a është 10% nga të hyrat që duhet të shkojnë nëpër komuna? Kjo është pyetja ime: a është e vërtetë apo jo? Dhe në këtë rritje, për secilin që e ka një pasqyrë, pra 112 milionë është rritje e parashikuar nga të hyrat që i bie që me qëllim, kjo rritje a po shkojnë 10%, se janë nga të hyrat, a po shkojnë në komuna? A është e vërtetë, pra, edhe një herë, që me formulë u takon nga buxheti i cilido vit, gjithmonë nga të hyrat 10% të hyrave të shkojnë në komuna? Nëse është e pavërtetë, thuaj, ministër, po ti po mashtron.

Pjesa tjetër, edhe një herë: nuk e ke planifikuar nga të hyrat, po mbulohet paga e 13-të, që i bie që ti nuk e ke planifikuar me kohë, ose ke mashtruar. Atëherë, e keni bërë këtë planifikim në këtë rritje prapë për t'u dukur që ju po i subvenciononi, po u jepni pagën e 13-të, por në fakt me mashtrime. Edhe një herë, nuk mashtroj, ministër, e keni për obligim që të kërkoni falje siç duhet t'i kërkoni falje secilit prej atyre që ua ke mohuar me kohë ta marrin përvojën e punës.

Është e drejtë e tyre, Gjykata të ka treguar që ke bërë shkelje, dhe nuk je duke ua qitur ti, as Qeveria juaj, por ua ka qitur një vendim i Gjykatës. Pra, po kthehen mjetet aty ku është dashur me kohë, se edhe atëherë keni bërë planifikim jo të mirë dhe planifikim të keq që e sjell dështimin.

KRYETARJA: Replikat përfunduan. Ministër, tre minuta. Zoti Mustafa dhe e mbyllim diskutimin.

ARBEN MUSTAFA: Kështu, fillimisht për sa i përket dividendës, ministri do të duhej të na shpjegonte prej cilave kompani do të marrë dividendë. Nuk ka logjikë të kërkojë dividendë që shkon përtej profiteve. Ne e dimë që shumica e kompanive publike janë në gjendje të rëndë. Me këtë po thoni që doni t'i shtini në borxhe kompanitë publike për t'u dhënë juve dividend, a? Po ku i merr 30 milionë kur s'i kanë 30 milionë fitim kompanitë publike? Po atëherë tregona prej cilave kompani po e merr dividendën!

Sa i përket pagës së 13-të, thatë që jepni në fillim të vitit: vetë emri "pagë e 13-të" tregon që kjo nuk ka logjikë! Për të marrë pagën e 13-të duhet pasur 12 paga që i ke marrë në sektorin publik, e pastaj vjen paga e 13-të. Dhe, këtu po manipuloni, për shkak se e keni thënë të qartë që paga e 13-të është dhënë për vitin 2025 dhe tash duhet t'u tregoni punonjësve të sektorit publik: a ka pagë të 13-të apo jo për vitin 2026?

Dhe, tjetra, i keni paraparë 20 milionë për pensione. Edhe te pensionistët është krijuar përshtypje që keni për t'iu dhënë ndihmë kësaj here, apo edhe t'ua rritni pensionet me këto 20 milionë euro?

A po na tregoni për çka i keni paraparë këto 20 milionë euro për pensione bazë të cilave ju keni referuar? A t'i mbyllni hendeqet nga e kaluara kur i keni dhënë para zgjedhjeve, apo do t'u jepni ndihmë pensionistëve edhe këtë herë, kur nuk po presim që do të ketë zgjedhje së shpejti?

Kështu që është mirë të shpjegoni edhe këto 20 milionë euro: a janë për pensionistët për këtë vit, të presin pensionistët diçka prej jush, apo e keni për t'i i mbyllur ato shpenzimet për blerje të votave që i keni bërë më herët?

KRYETARJA: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Vazhdojmë me amendamentet. Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej shtatë amendamente: dy nga komisioni përgjegjës raportues, ju lutem, të mbani qetësi, një nga Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Personat e Pagjetur dhe katër nga deputetët, pa përkrahje nga Komisioni përgjegjës raportues.

Tani vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së përcaktuar në raportin e Komisionit përgjegjës.

Vazhdojmë me amendamentet, pra në pjesën tekstuale të projektligjit që është amendamenti i parë i propozuar nga Komisioni përgjegjës raportues.

Ka prezantuar raportin kryetari i komisionit, deputete. Është amendamenti i parë nga Komisioni përgjegjës raportues, mos i ke ngatërruar, komisioni, jo deputeti, është Komisioni përgjegjës, kryetari i komisionit. Pastaj, kemi amendamentet të tjera dhe e merr fjalën.

Prezantimin e raportit të komisionit e ka bërë kryetari, përveçse në rrethanat kur e delegon këtë të drejtë.

Vazhdojmë me amendamentin 1. Regjia, ju lutem që të na mundësoni votimin. Votojmë tash!

Raportin e keni para vetes.

Nuk ka kuorum! 61 duhen, nuk i kemi.

Mos lëvizni, ju lutem, deputetë, jemi në proces të votimit. Gjithçka çka keni nuk është, besoj, më e rëndësishme sesa votimi i këtij ligji.

Përsërisim votimin për amendamentin një, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti i parë.

Amendamenti 2, që është propozuar nga Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Personat e Pagjetur, që nuk e ka mbështetjen e Komisionit përgjegjës raportues.

Prandaj, regjia, ju lutem që të na mundësoni votimin. Votojmë tash!

E ndërpresim procesin e votimit. Urdhëro, Time!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetare!
Amendamenti i parë, në nenin 6 të projektligjit, që ka të bëjë me nenin 32 të ligjit bazik, të paragrafit dy, neni 32a: në fund të tekstit, shtohet teksti si në vijim, që e kemi bërë bashkë edhe me Arben Gashin dhe me deputetë të tjerë: të shtohet edhe 1 milion euro për pajisjet, protezat dhe mjetet e tjera mjekësore për invalidët e luftës.

Këtu është minimizuar kjo kërkesë, duke shkuar veç te protezat, por në fakt nuk është ashtu. Kur e kam propozuar amendamentin dhe e kam diskutuar me deputetët, nuk jam ndalur vetëm te protezat, kam pasur edhe kërkesa të tjera, siç po shihet edhe nga vetë amendamenti, që nuk kanë qenë veç proteza. E kemi pasur ndërmend edhe rehabilitimin e invalidëve të luftës.

Kryetare e Kuvendit, një karrocë invalidore është jetë për invalidin e luftës. Ajo duhet të jetë e personalizuar, që do të thotë në bazë të peshës, në bazë të madhësisë, dhe kur nuk është adekuate, ndikon edhe në shtrembërimin e shtyllës kurrizore. Kam foto të një karroce të pandërruar prej 10 vjetësh, të lidhur me konopë e me tela, që e kanë përshtatur vetë, për shkak se s'kanë pasur buxhet për ta ndërruar atë karrocë invalidore. Trajtimet jashtë institucioneve shëndetësore publike, ju e dini që paguhen vetëm 70% dhe 30% duhet të paguhen nga invalidët e luftës.

Por, kur shifra është e madhe, sado që është shifra, 30% është tepër shumë për një invalid të luftës. E tani ka qenë e nevojshme dhe ende është e nevojshme t'i përkrahim këto kategori, e jo të kujdesen shokët dhe të afërmit për sigurimin e çfarëdo lloj trajtimi që duhet për invalidët e luftës. Ata duhet të trajtohen në mënyrë adekuate për hir të kontributit dhe për hir të krejt asaj çka kanë dhënë për vendin.

Shpesh ata po bëhen objekt debati dhe po sulmohen nga këto "ushtria e Fejsbukut" për shkak të kërkesave të tyre, po na shani neve, na fyeni neve, por nuk keni të drejtë, nuk kanë të drejtë që t'i

fyejnë invalidët e luftës. Kryetare, këtu me vete i kam pamjet e një karroce invalidore... Fokusohuni, ju lutem!

KRYETARJA: Amendamenti, deputete...!

TIME KADRIJAJ: Diku janë të lidhura me tenda, e diku janë të lidhura me konop, edhe ky invalid ka nevojë për sigurimin e kësaj.

KRYETARJA: Deputete, unë kisha informacionin që ju po flisni në emër të komisionit. Pra, nuk është që po flisni në emër të komisionit, ju lutem që të jeni korrektë, po mund ta merrni fjalën pas kryetarit të komisionit.

Unë kisha informacionin se ju është deleguar që të flisni në emër të komisionit, dhe kur të flisni në emër të komisionit, flisni në emër të komisionit. Prandaj po vazhdojmë me kryetarin e komisionit, Arton Konushevci. Urdhëro, kryetar!

ARTON KONUSHEVCI: Faleminderit, kryetare!
E gjithë kjo që u tha pak më parë nga anëtarja e komisionit që unë drejtoj aspak nuk qëndron. Në momentin kur është propozuar nga deputetja, ka qenë në dijeni se një gjë e tillë nuk ka nevojë, për faktin se Ministria e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, SHSKUK-ja dhe QKUK-ja i ofrojnë të gjitha shërbimet për invalidët e luftës së UÇK-së, kjo është e para.

E dyta, e kemi thënë disa herë edhe në komision edhe kemi pasur informacione që të gjitha kërkesat, nuk ka asnjë person i cili pret për të marrë përgjigje lidhur me protezat e tyre, por konsideroj se gjithë kjo po bëhet duke keqpërdorur edhe UÇK-në. Është e papranueshme që kohë pas kohe, vit pas viti, një gjë e tillë po bëhet, kanë bërë përfitime të njëpasnjëshme në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe kjo njëherë e përgjithmonë duhet të ndërpritet. Prandaj, ne nuk mendojmë që duhet të kalojë ky propozim i deputetes. Faleminderit!

KRYETARJA: Unë nuk po kuptoj, a po kuptoni, sinqerisht? Ne e kemi propozimin e amendamentit të dytë që është propozuar nga Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, pra është propozim i komisionit që nuk është përkrahur, domethënë pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Këtë çështje e kemi. Urdhëro, deputet, urdhëro, kryetar!

ARTON KONUSHEVCI: Arsyeja pse është përkrahur dhe ka kaluar te komisioni tjetër për buxhet ka qenë që le të kalojë te ky komision, dhe pastaj le ta anulojnë ata.

Çështja është se edhe deputetët të cilët kanë kërkuar këtë amendament kanë thënë që: le t'i bëjmë ne këtë 1 milion euro, le ta lëmë aty, pastaj ua gjejmë vendin ne. Është shumë e vërtetë!

Në qoftë se e kontestoni këtë që po e them unë, e kemi procesverbalin dhe është incizuar gjithë mbledhja e komisionit.

KRYETARJA: Po, natyrisht, diskutimet janë të incizuara në komisione parlamentare. Urdhëro, deputet Gashi, urdhëro.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!
Kryetari i komisionit ka për detyrë që ta lexojë raportin e komisionit, pastaj mund me marrë fjalën si deputet edhe me dhënë vlerësimin personal, e para.

E dyta, amendamenti thotë: "Në fund të paragrafit shtohet edhe 1 milion euro për proteza, mjete, pajisje dhe shërbime të tjera të nevojshme për invalidët e luftës." E kam draftuar vetë, e kam deklaruar vetë në komision dhe është e shkruar dhe e incizuar. Ideja është që, me kërkesën e deputetes, ish-ushtares së UÇK-së, veterane Time Kadrijaj, që kësaj kategorie t'i mundësohen shërbimet e nevojshme. Kjo është votuar në komision dhe jo vetëm për proteza, pra proteza, mjete dhe shërbimet e tjera të nevojshme për invalidët e luftës. Ka transkript edhe ka vendim!

Të nderuar, unë po ju kuptoj që është pak.

KRYETARJA: Mos u merr, more, ti me deputetët, po merre fjalën edhe fol për çështjen!

Mos u merr ti me të tjerët!

ARBEN GASHI: Nuk është ideja me bë debat për këtë temë, sepse në fund të fundit bëhet fjalë veç për 1 milion euro, dhe këta invalidë kanë nevojë për trajtim mjekësor, për trajtim në aspektin fizik, për trajtim në aspektin e përkrahjes psikologjike. Pra, ideja e amendamentit është për proteza, mjete dhe shërbimet e tjera shëndetësore.

Ky është definicioni që është dhënë për këtë amendament dhe kjo është nevoja, pse e kanë reduktuar këta në diskurs publik; është temë tjetër. E shkruar dhe e nënshkruar është këtu, e ka përkrahjen e komisionit, është votuar me unanimitet në komision, pastaj në Komisionin për Buxhet dhe Financa nuk e ka gjetur përkrahjen. Ne jemi në përkrahje të këtij amendamenti dhe duhet të kalojë. Bëhet fjalë për nevoja, përkrahje, shërbime mjekësore, qofshin ato në aspektin fizik, qofshin ato në aspektin e shëndetit mendor, emocional e të tjerë. Pra, është një kategori që ka shumë nevojë për përkrahje profesionale, një kategori për të cilën ne kemi obligim që t'u ofrojmë këto shërbime, dhe kostoja është minimale, është kosto minimale.

Prandaj, nuk po e kuptoj pse po bëhet kjo punë, pse po luhet kështu, kur bëhet fjalë në të njëjtin amendament, në të njëjtin rend të ligjit të propozuar janë 14 milionë euro për paga e për të tjerë. Bëhet fjalë për shërbime shëndetësore, të cilat ata kanë nevojë me i marrë, dhe jo vetëm ata, por

ka edhe viktima civile të luftës edhe kjo kategori ka nevojë. Me këtë duhet me u marrë në buxhetin e ardhshëm. Ne si komision jemi marrë vetëm me këtë kategori, sepse e kemi parë emergjente, ka nevojë për përkrahje, s'kemi nevojë me u përçarë politikisht për këtë punë, duhet t'i japim këtë përkrahje. Kërkoj mirëkuptimin e gjithë deputetëve dhe të vazhdojmë tutje. Faleminderit!

KRYETARJA: Shihni, unë kam para vetes shumë deputetë që janë paraqitur për fjalë, por çështja është që e kuptojmë qëllimin, e dimë qëndrimin, le të votojmë: për, kundër ose abstenim, është në vullnetin e grupeve parlamentare, përkatësisht deputetëve. Mos mendoni që sot, me qasjen që po e shoh, keni me mund ta bindni njëri-tjetrin për apo kundër, a abstenim; mos mendoni që keni me mbërritur këtë. Përkundrazi, veç mund me bë më keq se mirë, assesi jo.

Vazhdojmë. Të lutem, Arian, çdoherë po më thua për hir të korrektësisë e respektit e të tjera, vazhdojmë me votimin, edhe ju lutem fokusoheni te procesi i votimit edhe përcaktoheni me votë.

Mandej rrjetet sociale, konferencat për media mos i ndalni, vazhdoni aty dhe flisni për këtë çështje.

Vazhdojmë. Votohet për amendamentin 2, që është propozuar nga Komisioni për Mirëqenie Sociale pa përkrahjen e komisionit përgjegjës. Votojmë tash!

Pra, Komisioni për Mirëqenie e ka propozuar, po normal se komisioni kur ka mbështetje e propozon jo pa mbështetje nuk mund ta quaj në emër të komisionit kur s'ka mbështetje të shumicës aty, dhe pastaj komisioni përgjegjës që është Komisioni për Buxhet nuk e ka mbështetur, e sqarova.

Pra, nuk miratohet! 42 vota kundër, 30 për. Atëherë nuk kalon amendamenti 2.

Vazhdojmë me amendamentin 3, që është propozuar nga deputetja Teuta Haxhiu. A e dëshironi fjalën, deputete? Urdhëro, arsyetoje.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!
Pra, së pari, para se ta lexoj amendamentin, kërkoj një korrigjim teknik të viteve, pra është fjala për ndërtimin e Kompleksit Memorial për fëmijët e vrarë në luftë në vitin 1998-1999. Ky është një gabim teknik edhe kërkoj që të përmirësohet.

Tani, kryetare, më lejo, të lutem, të kërkoj mirëkuptimin e deputetëve tanë edhe ulu pak, të lutem! Kërkoj mirëkuptimin e secilit deputet, për shkak se një amendament i tillë që është kërkuar do duhej nga secili që të vjen, unë në asnjë formë nuk e kisha refuzuar. Po kërkoj

ndërtimin e një kompleksi, obelisku për fëmijët e vrarë në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë, që janë mbi 1 mijë e 436 fëmijë.

Po ju rikujtoj si deputetë, sepse është njerëzore, cilido që ta bëjë amendamentin, por nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2015 kam bërë një amendament në kohën e Qeverisë Mustafa për Mejen, Kompleksin Memorial Meja. Atëherë, nuk kisha kërkuar se ku me i marrë mjetet; ky amendament decidivisht tregon edhe ku do të merren mjetet. Pra, është vlera diku rreth 600 mijë euro.

Për mua është pak me rëndësi ku ndërtohet, në atë kohë e kanë votuar deputetët edhe pse s'ka pasur përkrahje nga Komisioni për Buxhet, e kanë votuar deputetët që kanë pasur ndjenja, po flasim për masakrën më të madhe në Kosovë që ka qenë Meja, pra me 376 të vrarë të dy besimeve.

Sot po flasim në një periudhë tjetër, mbas 27 viteve, por po flasim për fëmijët, fëmijët të cilët nuk e kemi një memorial, pra askund në Kosovë. Pra, këtu nuk shihet as Teuta, asnjë deputet. Atëherë kur kishin guxim, u ndërpre seanca në atë kohë, edhe pse ishte ora 24:00, dhe Kryeministri Mustafa e ka ndërprerë, ka shkuar, i ka gjetur mjetet, kodin, gjithçka, edhe janë ... mjetet.

Prandaj, edhe sot ju lutem, kolegë e kolege deputetë, nga secili subjekt politik, mos e shihni Teutën fare. Është një amendament që kërkon një vlerë jo më të madhe se rreth 600 mijë euro për fëmijët e vrarë në luftën e fundit, është historia. T'i kujtojmë pra kudo qofshin ata. Unë e kam treguar që është një projekt, po nuk është me rëndësi për mua, le të bëhet ky projekt, le të vendoset ku të duan, vetëm le të shënohet në cilëndo komunë, edhe në kryeqytet, por unë kam treguar një procedurë më të shpejtë, që është edhe një pronë e ndarë.

Pra, unë po kërkoj mirëkuptimin e juaj që ta përkrahni, jo për mua, për gjithë ata fëmijë që kanë emër e mbiemër, për shumë familje që nuk kanë as trashëgimtarë për shkak të vrasjes së fëmijëve në atë periudhë. Janë për fëmijë, për t'i fëmijët e vrarë në luftë, këtë po e kërkoj.

Prandaj, edhe një herë kërkoj mirëkuptimin e juaj. Ka ndodhur një gjë e tillë, është votuar një amendament. Kjo është një histori, nuk është individi as partia politike. Kërkoj mbështetjen e juaj edhe kërkoj mirëkuptimin e juaj që të jemi bashkë në këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministrja Bogujevci! Urdhëro, ministre.

MINISTRJA SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryetare!
Unë kam diskutuar edhe me zonjën Haxhiu, dhe kam njoftuar që në fakt kemi buxhet: është 1 milion të ndara për memorialin e fëmijëve të vrarë gjatë luftës, është pjesë e buxhetit. Edhe më

vjen keq që duhet të kërkoj që mos të përkrahet amendamenti për arsyen që ekziston buxheti, ka shpjeguar edhe gjatë pyetjes parlamentare që ia keni bërë kryeministrit që domethënë jemi në proces të ndërtimit. Kështu që kjo veçse ekziston.

KRYETARJA: Unë mendoj që tabelat buxhetore janë shumë të qarta, projektet po ashtu janë shumë të qarta, dhe nuk e di se çka ka, edhe kodin buxhetor e merr përsipër ministri Murati me na treguar, nëse kjo ndihmon. Po s'po di, ministër, urdhëro, të lutem.

Po po, e merr fjalën, deputete, patjetër, prandaj jemi.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Veç sa për korrektësi, po për ta dëshmuar atë që e tha ministrja, edhe kodi buxhetor pra i projektit në fjalë është 19399.

KRYETARJA: Faleminderit, ministër, për sqarimin. Po, deputete, replikë!

TEUTA HAXHIU: Absolutisht nuk është e vërtetë. Kryetare, a bën?

KRYETARJA: Po, po ta dhashë fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!
Vërtet, edhe një herë, unë kërkova mirëkuptim, sepse kjo nuk është e vërtetë, është kamuflim! Këtë do ta shohim. Unë sot po ju them nuk ka kod, nuk ka kod buxhetor për ndërtimin e kompleksit.

Sarandë, ministre, edhe një herë ju lutem, nëse diku gjeni që ka kod për ndërtimin e kompleksit, çështja që kemi biseduar, ministre: jemi duke punuar në këtë drejtim, është diçka tjetër. Kod buxhetor nëse ka të ndarë, atëherë publikoni kodin që thotë "Ndërtimi i kompleksit", as edhe një cent. Ju lutem, mirë, edhe një herë me kujdes unë po ju them, gjeni dhe publikoni se ku është kodi për ndërtimin e kompleksit memorial, vetëm këtë pjesë. Unë edhe një herë, kryetare, po kërkoj mirëkuptimin e deputetëve, nuk ka kod buxhetor për amendamentin, për ndërtimin e një obelisku, kudo qoftë ai.

Edhe një herë, unë kërkoj mirëkuptimin, nuk ekziston një gjë e tillë. Unë nuk e kam plan me bërë zhurmuesen, por kërkoj mirëkuptimin e njerëzve për gjithçka që unë e them këtu ju më demantoni me fakte. Nuk ka kod buxhetor për këtë!

Prandaj, kryetare, unë kërkoj mirëkuptimin e deputetëve, ju lutem. Është fjala për një plagë, një dhimbje të fëmijëve që janë më shumë se 1 mijë e 436, që e ka thënë një djalë në Skenderaj, që unë hala nuk e kam takuar, por ai fëmijë është vetë sot e kësaj dite.

Prandaj, edhe një herë, secili që ka ndjenja e voton. Nëse ka kod buxhetor, atëherë pse mos propozohet në fund bashkë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Ministre, urdhëro, të lutem, për sqarim.

MINISTRJA SARANDA BOGUJEVCI: Zonja Haxhiu, e kuptoj, ne kemi punuar bashkë, dhe e kuptoj ndjeshmërinë që e ke në raport me çështjet e luftës. Të lutem, nuk ka këtu kurrgjë në raport me njëra-tjetrën, as nuk dua me u bë që ti të ndihesh keq.

Vetëm po tregoj që ekziston kodi buxhetor, domethënë tregova saktë shifrën sa janë ndarë për memorialin e fëmijëve, ekziston dokument 700 faqe të intervistave me familjarët për fëmijët e vrarë gjatë luftës, kam qenë e përfshirë edhe kur kam qenë deputete këtu, kështu që ekziston.

Unë vetëm këtë po e them: nëse një amendament i tillë votohet, veç ndoshta për sqarim e rrëzon planifikimin 1milionësh që janë në buxhet me 600 mijë. Veç po e sqaroj, kështu që vetëm po e tregoj që ekziston për atë arsye.

KRYETARJA: Vazhdojmë me votimin e amendamentit. Nuk ka të drejtë!

Vazhdojmë me votimin e amendamentit. Ju lutem që të mbani qetësi! Ju lutem që të mbani qetësi! Është shumë e vështirë për ta menaxhuar një seancë kur ka zhurma nga të gjitha anët. Unë e menaxhoj prapëseprapë, por nuk është në rregull në seancë plenare me pasur kaq shumë zhurmë.

Vazhdojmë votimin për amendamentin numër 3, i propozuar nga deputetja Haxhiu pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Votojmë tash!

Me 45 vota kundër, 23 për, nuk kalon amendamenti 3, i propozuar nga deputetja Teuta Haxhiu.

Vazhdojmë me amendamentin 4, 5, 6, që janë të deputetes Ariana Musliu-Shoshi. Nëse dëshironi, deputete, mund t'i prezantosh të tria, ose veç e veç, pastaj, ju vendosni.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!
Fillimisht, për korrektësi, nga viti 2019 deri ditën kur po flasim sot në këtë minutë, asnjë propozim e amendament i deputetëve të opozitës nuk ka kaluar nga kjo Qeveri, pavarësisht a ka qenë në rishikim të buxhetit apo në votim të buxhetit për herë të parë. Pra, asnjë amendament, asnjë propozim i joni si deputetë të opozitës nuk ka kaluar.

Prandaj, nuk është çudi që edhe këto amendamente sot që po i propozojmë, edhe ato që do t'i propozojmë me buxhetin e vitit 2027, nuk do të kalojnë. Sidoqoftë, për korrektësi unë po i lexoj amendamentet, të cilat i kam propozuar në komision, e të cilat vlerësoj që kanë një urgjencë të veçantë.

Meqë ne jemi në muajin tetor dhe po flasim për solidarizim me të gjithë ata që janë të prekur me kancer, unë kam bërë kërkesë që të ndërtohet Qendra e Kujdesit Paliativ. Këtë kërkesë e kam nga viti 2021 që e paraqes në vazhdimësi sa herë vjen buxheti në këtë Kuvend. Shuma që kam kërkuar është 4 milionë, dhe e dimë të gjithë që kujdesi paliativ është një nga shërbimet më të domosdoshme shëndetësore dhe humanitare që synon përmirësimin e cilësisë së jetës të pacientëve që përballen me sëmundje të rënda progresive dhe të pashërueshme. Kosova është shteti i vetëm pra, është shteti i vetëm në rajon dhe në Evropë që nuk ka qendër të kujdesit paliativ.

Propozimi im i dytë ka të bëjë me ndërtimin e Qendrës për Fëmijët me Autizëm, Sindromin Down dhe nevoja të tjera të veçanta. Kam kërkuar që të ndahen 2 milionë nga buxheti ynë, sepse fëmijët me nevoja të veçanta nuk kërkojnë privilegj, mirëpo kërkojnë atë që e meritojnë nga shteti, të paktën një mbështetje dhe mundësi të barabarta për përkujdesje ndaj tyre, e këtë duhet ta marrin nga institucionet. Nuk kam hasur në përkrahje nga Komisioni për Qendrën për Fëmijë me Autizëm, mirëpo të shohim se çfarë mendimi kanë deputetët tani. Shuma e thashë është 2 milionë. Po ashtu, jemi shteti i vetëm në rajon dhe shteti i vetëm në Evropë që nuk ka qendër për fëmijët me autizëm.

Ndërsa propozimi im i tretë vjen në këtë Kuvend nga viti 2023-2024, atëherë kur kam qenë anëtare bashkë me Sarandën dhe shumë të tjera këtu në Komisionin për Mirëqenie, dhe kërkesa që e kam pasur që nga ai vit e deri më sot është përmirësimi i qasjes infrastrukturore në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe shuma që kam kërkuar është 800 mijë euro. Asnjë fëmijë në republikën tonë nuk duhet të mbetet jashtë shkollës për shkak të shkallëve, për shkak të dyerve, për shkak të rampave dhe barrierave të tjera që shteti ka përgjegjësi që t'i rregullojë.

KRYETARJA: Faleminderit, deputete! Po vazhdojmë me amendamentet radhë me radhë. Amendamenti i katërt, pra, nga deputetja Ariana Musliu-Shoshi, që nuk e ka përkrahjen e komisionit përgjegjës. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

48 deputetë kanë votuar kundër, 23 deputetë pra duke përfshirë votën e deputetes Musliu - kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon ky amendament.

Vazhdojmë te amendamenti 5, që është propozuar nga deputetja Ariana Musliu-Shoshi pa përkrahjen e komisionit përgjegjës. Votojmë tash!

45 deputetë kanë votuar kundër, 22 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon amendamenti pesë.

Dhe amendamenti 6, që është propozuar po ashtu nga deputetja Ariana Musliu-Shoshi pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Votojmë tash!

70 deputetë kanë marrë pjesë të gjithë në votim, pra gjithsej 49 deputetë kanë votuar kundër, 22 për, asnjë abstenim. Nuk kalon as amendamenti gjashtë.

Dhe vazhdojmë me amendamentin shtatë, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti shtatë.

Vazhdojmë me procedimin, me votimin e Projektligjit nr. 11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, me amendamentet e miratuara.

Lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës, që është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 11/L-006 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme

Të nderuar deputetë,
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës raportues, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara nga komisioni përgjegjës raportues.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit përmbajnë kosto shtesë buxhetore, por të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime shtesë buxhetore. Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë pjesërisht në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ndërsa Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim ka

vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat e interesat e komuniteteve.

Në vijim ftoj kryetarin e komisionit, zotin Qorolli, për ta paraqitur raportin dhe për të arsyetuar atë. Urdhëro.

VIGAN QORROLLI: Faleminderit, zonja kryetare.
Më lejoni që të paraqes para jush Projektligjin nr. 11/L-006 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Legjislacion.

Ky projektligj ka për qëllim themelimin, organizimin dhe përcaktimin e kompetencave të Byrosë Shtetërore për Verifikimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, si dhe përcakton procedurën për verifikimin dhe konfiskimin e kësaj pasurie.

Komisioni, më 23 tetor miratoi raportin me amendamentet dhe e përcolli në komisione të përhershme për shqyrtim. Komisionet përkatëse, sipas kompetencës, e shqyrtuan projektligjin së bashku me amendamentet. Duhet sqaruar këtu se amendamentet janë ndarë dhe listuar sipas referimeve në nene dhe paragrafë, sipas teknikës ligjore të hartimit të ligjeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Andaj, amendamentet sa kanë qenë gjashtë gjithsej, tashmë janë 12 pas ndarjes, ashtu siç përcaktohet me Rregulloren e Punës së këtij Kuvendi. Nga këto 12 amendamente, vetëm një amendament është përkrahur nga komisioni.

Prandaj, në raportin final janë pasqyruar gjithsej 24 amendamente: 13 amendamente të komisionit dhe 11 amendamente të tjera pa përkrahje të komisionit. Prandaj, Komisioni për Legjislacion, pas shqyrtimit të raporteve të komisioneve të përhershme në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, më 26 tetor vendosi t'ia paraqesë Kuvendit këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit miratimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 11/L-006 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, me amendamentet e komisionit.

Gjithashtu, zonja kryetare, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje të japim mbështetjen tonë të plotë për kalimin në lexim të dytë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar kryetar! Tani vazhdojmë, jo, nga PDK-ja nuk kam, ndoshta, flet Përparimi te amendamentet. Atëherë, zonja Doarsa Kica-Xhelili nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit!
E keni parasysh që LDK-ja ka votuar këtë projektligj në lexim të parë me kërkesën që në mes të dy leximeve t'i bënim intervenimet e nevojshme që ky ligj të bëhej efektiv, i drejtë, i pavarur, edhe të arrinte qëllimin për të cilin edhe ishte nisur. Ka vite që drejtësia këtu në Kuvend po servohet ndryshe nga realiteti që e kemi në terren. Shpesh këto iniciativa ligjore po na shiten për atë që nuk janë, po premtohet diçka tjetër, në letër po shkruhet diçka tjetër, dhe në fund, kur vjen puna te zbatimi dhe rezultatet, po ndodhin ato që po na ndodhin çdo ditë.

Fatkeqësisht, edhe me rastin e Byrosë po e rrezikojmë çështjen e njëjtë.

Të dashur qytetarë, kolegët e mi deputetë pak a shumë veçse kanë vendosur si të votojnë në raport me këtë projektligj, dhe jam e bindur që votën e tyre s'mund ta ndryshojë sot. Prandaj, unë dua sot të flas me ju, dua që në momentin që të përmbyllet ky votim, ju ta dini saktësisht se çka është votuar. Duhet ta dini, sepse nesër, kur të zbatohet ky projektligj, nuk do të zbatohet premtimi që thuhet këtu, por do të zbatohet teksti i ligjit që do të kalojë sot.

Sot kjo Byro nuk është më ai institucion që u referohej si një mekanizëm që do t'i luftonte "peshqit e mëdhenj" për shumat milionëshe që ata i kishin marrë në formë të kundërligjshme nga shteti i Kosovës. Sot kemi një byro që ka dy rreziqe madhore: e para, do të përdoret si shantazh politik; e dyta, do të pengojë ndjekjen penale të atyre që realisht kanë vjedhur.

Dhe më lejoni t'ju sqaroj të gjitha:

Së pari, ky ligj thotë që shtrihet zbatimi nga 17 shkurti i vitit 2008, ku mospërputhja kalon 25 mijë euro. E keni parasysh si ilustrimi i bie rreth 100 euro në muaj, dhe mendojeni vetëm një hua familjare që e keni marrë në vitin 2009, ose kursime të tjera që i keni sjellë nga jashtë vendit, ose mendoni remitancat e kumuluara ndër vite pra, thashë, rreth 100 euro në muaj diskrepancë. Tani, Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e vitit 2024 kërkoi proporcionalitet dhe garanci për pamundësinë objektive të sigurimit të provave.

Në ligjin para vetes vetëm është thënë: "pamundësi objektive" nëse pala ka pamundësi objektive që të sigurojë dëshminë. Si zbatohet kjo "pamundësi objektive"? Nuk mund të merret marrë një rekomandim i Gjykatës Kushtetuese dhe, pa e analizuar mirë si të vendoset në projektligj, vetëm të thuhet "nëse ka pamundësi objektive". Çka nënkupton "pamundësi objektive"?

A nënkupton pamundësi objektive remitanca e marrë në vitin 2010? A nënkupton pamundësi objektive një kontratë mes dy personave fizikë, e asnjëri nuk e ka ruajtur dokumentin sepse ka qenë i vitit 2010? A nënkupton pamundësi objektive që s'e ke origjinalin e një dokumenti, e personi me të cilin ke kontraktuar sot është jashtë vendit? Çka është pamundësia objektive? Për këtë ligji nuk flet fare. Fundja, një vijë shumë e hollë e ndan deklarimin e rrejshëm nga

pamundësia reale me e evidentuar pronën tënde. Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron dhe kërkoi që me ndryshimin e një vlere, e cila nga 25 mijë euro do të ngrihej në rreth 50 apo 100 mijë euro, vërtet do t'i verifikonim "peshqit e mëdhenj", e jo t'i kapnim zyrtarët me 100 euro diskrepancë në muaj. Nuk na u pranua ky propozim në grupin punues, mu tha që është dashur t'i bëje me shkrim dhe unë tregova që unë jam deputete e këtij Kuvendi dhe jam në grupin punues, dhe në grupin punues mund t'i bëj ndryshimet që i shoh të nevojshme, nuk u pranuan!

Një çështje që dua të fokusoheni vetëm pak, sepse është pak komplekse dhe po tentoj ta sqaroj sa më thjesht: E keni një nen 79.5 atje, i cili thotë kështu: "asnjë deklaratë dhe asnjë dëshmi nga kushdo që jepet në këtë proces nuk mund të përdoret në procedurë penale". Tani, nëse unë e kam një dokument të vetëm origjinal me një kontratë që e kam bërë në vitin 2010 me një person fizik, dhe unë e dorëzoj si të vetmin dokument origjinal pranë Byrosë, Prokuroria s'mund të ma përdorë atë dokument për të më ndjekur penalisht!

Pra, unë mund lirshëm t'i vjedh 50 mijë euro me i fut në qarkullim, nga ato me i gjeneruar miliona euro, në procedurë penale mua gjyqtari ma konfiskon edhe 50 mijë euro të vjedhura, edhe milionëshin e gjeneruar më pas për shkak që e kam futur në treg 50 mijë euro, e çka ndodh me këtë rast? I bie që, meqë i kam dorëzuar dëshmitë pranë Byrosë, këto dëshmi dhe deklarata nuk munden më me u përdorur në procedurë penale. Pra a jemi duke rrezikuar me i amnistuar pikërisht ata pasurinë e të cilëve jemi munduar me e marrë përmes këtij projektligji?

E dyta, aty thotë që, pasi përfundohet funksioni publik, janë edhe pesë vite të tjera, supozoni se s'jeni më deputetë edhe pesë vite të tjera që Byroja ka të drejtë me ta analizuar pasurinë dhe me ta konfiskuar, me bërë propozimin për verifikim-konfiskim më pas në gjykatë. Po a e dini çka nuk sqarohet? Vlera e diskrepancës që duhet me pasur mbas atyre pesë viteve të ardhshme.

Pra, është e vërtetë që nga viti 2008 thuhet që vlera e diskrepancës është 25 mijë euro, çka nëse është verifikuar që ajo pjesë ose është konstatuar që i keni vetëm 7 mijë euro diskrepancë e jo pjesa tjetër? Sa duhet me qenë pjesa e mbetur e pesë viteve të ardhshme? A duhet me qenë 25 mijë të tjera? A duhet me qenë shumë kumulative plus këto vite që i kemi lënë pas?

Pra, ju e dini që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese është thënë qartë që nuk guxojmë me lënë paqartësi të tilla në projektligj, sepse çdo normë e tillë do të mbetet jo kushtetuese. Prandaj në grupin punues i luta ta definojmë lartësinë, ta konkretizojmë dhe ta bëjmë normën kushtetuese, as kjo nuk u pranua!

Tjetra, te pavarësia dhe profesionalizmi i Byrosë: e keni parasysh që në këtë ligj duhet që edhe anëtarët e Byrosë edhe drejtori votohen me shumicën e thjeshtë të deputetëve prezentë. Tani ju e dini, nuk po flas me analogji, nuk po flas me një analizë hipotetike, po flas me atë që po na ndodh këtu në Kuvend, sa herë na keni thirrur në seanca me ardhur në një seancë pas pesë

minutave, pas 20 minutave? Ju e dini që ne kemi pasur ftesa për seanca përpara pesë minutave që kanë kaluar. Në çdo variant, një shumicë e këtij Kuvendi mundet me vetëm 31 vota me zgjedh drejtorin e Byrosë edhe anëtarët e tjerë të Byrosë. Po një institucion me kaq shumë kompetenca, ne po rrezikojmë me u zgjedhur me vetëm 31 vota të këtij Kuvendi!

Dhe çka është akoma më e rëndë është që, kur kemi insistuar që të paktën personat që do të jenë anëtarë të Byrosë t'i kenë të paktën shtatë vite profesionale përvojë, më thanë "s'ka nevojë" në grupi punues, "mjaftojnë pesë vjet përvojë pune". Për ku? Për Byro. Që në Administratë Publike i ke disa funksione shumë më të thjeshta sesa që do t'i kenë këta anëtarë të Byrosë, dhe në fakt nuk është kërkesa kaq e ulët. Pra, vërtet, për një projektligj që do të ketë kaq shumë kompetenca, vërtet është pak absurde.

E fundit për këtë çështje: mbyllja e rasteve. Pra, Byroja mundet me hapur raste, me mbyllur raste, me i rihapur prapë rastet, prapë me i mbyllur rastet, prapë me i rihapur rastet, me i mbyllur rastet e njëjta derisa ato nuk shkojnë në gjykatë, askush nuk jep përgjegjësi. Ia bën vetëm propozimin drejtorit: "Po e mbyll këtë rast." As arsyetim, as përgjegjësi, as llogaridhënie!

Supozojeni një byro me persona totalisht të pandërgjegjshëm, sepse risku ekziston gjithmonë, ne duhet të sigurohemi që nuk e lëmë këtë risk në ligj vjen dikush sa herë ka fushatë, ty ta hap një rast pa të drejtë, pa të drejtë me u mbajtur lart e poshtë në procedurat e brendshme të Byrosë e mbyll rastin, më pas sa herë ka nevojë, prapë e rihap dhe e mbyll. Pra, kjo është Byroja që e keni para vetes dhe që duhet ta votoni, dhe për këtë Byro ju po i thoni qytetarëve të vendit: "Do të konfiskojmë miliona euro të zyrtarëve të lartë." Ndoshta! Uroj!

Por a e dini çka po krijoni, a e dini çfarë monstrumi politik jeni duke e krijuar? Ky ka me mbetur edhe përtej nesh, edhe përtej jush, edhe përtej kësaj legjislature e këtij pushteti. Prandaj LDK-ja ka bërë me dhjetëra kërkesa në grupin punues, të gjitha vetëm në funksion, që ky ligj të bëhet i zbatueshëm, efektiv, i pavarur, dhe ne të vijmë këtu dhe ta votojmë me shumë kënaqësi.

Pra, në asnjë moment nuk kemi thënë "nuk e votojmë projektligjin", vetëm ju kemi lutur me na pranuar disa rekomandime tona që ne me ardhur sot këtu dhe me e votuar, me votuar një ligj të drejtë. Dhe, vërtet unë e kam të pamundur me kuptuar ku ishte problemi kaq i madh në propozimet që i dëgjuat ju sot për të mos i pranuar këto rekomandime. Ne insistojmë le të kthehet, po i bëjmë këto ndryshime të cilat i kërkuam sot, pastaj ejani, kërkoni votën e LDK-së dhe do ta keni. Po LDK-ja nuk mundet me ardhur këtu dhe me thënë që po votojmë një byro e cila nuk ekziston ky nuk është më ai institucion për të cilin jemi nisur.

Edhe një herë, nuk mund t'ua shesim qytetarëve një ligj që nuk është, sepse nuk mundemi në emër të drejtësisë me i hyjnë në hak njerëzve. Rrjedhimisht, për këtë fazë nuk mund ta votojmë

ligjin sikurse është, por nëse kthehemi dhe i implementojmë të gjitha ndryshimet që i kërkuam, do ta keni edhe votën e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KRYETARJA: Faleminderit! Po më duket si me u kthye pas në ato seancat e gjata, se fjalimet komplet të njëjta. Po urdhëro zoti Tahiri, ka thënë Gjykata Kushtetuese "bre, ku keni gabuar", edhe i kemi përmirësuar.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës, Aleanca, sikur herën e kaluar, edhe kësaj radhe do ta votojë për këtë ligj. Pse? Pse ua kam borxh qytetarëve të Kosovës edhe juve si deputetë të ju them disa qëndrime që mendoj duhet t'i dijë publiku.

E para, Byroja dhe në komision po e shoh atje një koleg që kemi qenë pesë vjet bashkë, i kemi thënë, thoshim "Byroi" ka ardhur që pesë vjet kemi diskutuar për këtë ligj, edhe jemi përpjekur për ta trajtuar përnjëmend në formën më të mirë të mundshme në komision. Sa herë që arrinim në një stad me përcjellë Ligjin për Byronë e konfiskimit të pasurisë së pajustifikueshme, dilnin disa amendamente të cilat pastaj e detyronin Kuvendin me lypë interpretim në Gjykata Kushtetuese, dhe kështu që pesë vjet ne jemi pa këtë institucion. Ndërsa, që pesë vjet e kemi temë kryesore, është ligji më i përfolur në Kuvend, i cili ka për qëllim për hetimin e pasurisë së zyrtarëve publikë të lartë dhe të mesëm, por njëkohësisht edhe luftën kundër korrupsionit, po pse jo edhe krimit të organizuar.

Tani kolegia Doarsa i trajtoi çështjet themelore, të cilat i ka ngritur edhe në komision, që i kemi ngritur më herët me Përparimin, me Blerën, dhe nuk po dua t'i përsëris. Mirëpo, një jua kam me borxh me ju thënë juve dhe qytetarëve të Kosovës: mos hajdeni mbas disa muajve me thënë "hajde e amandamentojmë këtë ligj, se qenka kundër kushtetues dhe po rënka ndesh seriozisht me ligjet të cilat e luftojnë korrupsionin dhe njëkohësisht e hetojnë çështjen të cilën duhet ta kryejë ky institucion".

Këto çështje i kemi ngritur në komision, jua kemi thënë dhe po jua themi edhe tash publikisht, ky ligj si është tash ka probleme serioze për të hyrë në zbatim për shkak se bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjet bazë dhe ligjet themelore që janë. Po ne po jua votojmë tash, do ta votojmë edhe kur të vijë prapë, se ky prapë vjen në Gjykatën Kushtetuese, prapë vjen të ju thotë që nuk e kemi përnjëmend se nuk e keni pasur përnjëmend as atëherë, e as nuk e keni tash! Është një instrument elektoral, i cili është përdorur në tri cikle zgjedhore bukur fort.

KRYETARJA: Nuk ka të tjerë të paraqitur. Thërrisni deputetët, ju lutem, shefat e grupeve të kujdesen që deputetët të jenë në sallë.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve: amendamenti një që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Ju lutem përgatituni për votim. Votojmë tash!

Alban, prit të kalojë ligji! Jo ende, tek amendamentet jemi. Amendamenti 1 kalon. Pra, me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Vazhdojmë me amendamentin 2, i cili është i propozuar nga deputeti Përparim Gruda. Pse, kryetar? Një sqarim. Urdhëroni! Sqarimin do të duhej ta bënit në fillim kur ta dhashë fjalën. Po, ishte çështje teknike. Faleminderit! Urdhëroni deputeti Gruda, ju lutem, që ta prezantoni amendamentin 2 dhe, nëse e shihni të nevojshme, më fal, keni shumë amendamente që keni propozuar nëse dëshironi t'i përmblidhni të gjitha, nëse jo, atëherë shkojmë veç e veç.

PËRPARIM GRUDA: Faleminderit!
Unë i kam paraqitur 24 amendamente si qëndrim i Partisë Demokratike të Kosovës, jo vetëm si deputetë që jemi. Unë për të kursyer kohën e kolegëve, unë po flas një minutë a dy në fillim dhe pastaj vetëm po i hedhim në votim.

Amendamentet tregojnë vullnetin e Partisë Demokratike të Kosovës për ta përmirësuar këtë ligj, dhe për ta votuar ashtu siç ka kërkuar Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe për të garantuar sigurinë juridike të të gjithë atyre që do të jenë subjekt i hetimit të kësaj byroje.

Mendoj se kemi bërë një punë të mirë me propozimin e të gjitha këtyre amendamenteve, dhe këto amendamente do ta bënin ligjin kushtetues në radhë të parë, të dobishëm për qëllimin për të cilin është hartuar, edhe do të garantonin sigurinë juridike, mbi të gjitha, për të gjithë ata që do të jenë subjekt i hetimit. Unë kërkoj nga të gjithë deputetët që t'i mbështetin këto amendamente dhe nuk do ta marr fjalën për t'i paraqitur secilin veç e veç. Ky është qëndrimi ynë për sa u takon këtyre amendamenteve. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gruda! Unë në raport i kam 12 amendamente tuajat. 24 janë gjithsej. Po, se të keqkuptova unë! Vazhdojmë me amendamentin 2, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda. Sqarimet u dhanë. Bëhemi gati për votim. Votojmë tash!

52 deputetë kanë votuar kundër, 18 deputetë, me votën e deputetes Musliu, për dhe 1 abstenim. Nuk kalon amendamenti 2. Vazhdojmë me amendamentin 3, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum, 57 deputetë. Kryetari i komisionit, a mund të vijnë ju lutem? Vazhdojmë te amendamenti 3 nuk ishte kuorum, pra vetëm 57 deputetë kanë marrë pjesë në votim, prandaj obligohem që ta vendos edhe një herë në votim. Amendamenti 3, i propozuar nga komisioni

përgjegjës raportues. Votojmë tash! 62 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 3.

Vazhdojmë me amendamentin 4, që është propozuar po ashtu nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Me 63 vota për, kalon edhe amendamenti 4, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Vazhdojmë me amendamentin 5, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Gjithsej 68 deputetë kanë votuar pro këtij amendamenti, por nga këta, 51 kanë votuar kundër, 17 deputetë kanë votuar për, 1 abstenim. Nuk kalon ky amendament.

Vazhdojmë me amendamentin 6, që është propozuar nga komisioni... Më falni! Nga deputeti Përparim Gruda, pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim, Votojmë tash! 53 deputetë kanë votuar kundër, 16 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon amendamenti 6.

Vazhdojmë me amendamentin 7, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash! 62 deputetë... Më falni se u nguta! 62 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 7.

Vazhdojmë me amendamentin 8, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

52 deputetë kanë votuar kundër, 16 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon amendamenti 8.

Vazhdojmë me amendamentin 9, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash! 62 deputetë kanë votuar për amendamentin 9. Asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon si i tillë.

Vazhdojmë me amendamentin 10, që është propozuar po ashtu nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Me 62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon amendamenti 10. Vazhdojmë me amendamentin 11, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash! 52 deputetë kanë votuar kundër, 15 deputetë kanë votuar për. Nuk kalon amendamenti 11. Asnjë abstenim s’ka për këtë amendament.

Vazhdojmë me amendamentin 12, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 12.

Vazhdojmë me amendamentin 13, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 13.

Vazhdojmë me amendamentin 14, që është propozuar po ashtu nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 14.

Vazhdojmë me amendamentin 15, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

51 deputetë kanë votuar kundër për këtë amendament, 16 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon amendamenti 15.

Vazhdojmë me amendamentin 16, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash! Më falni? Më fal, regjia! Po urdhëro, deputet!

PËRPARIM GRUDA: Po vetëm desha ta bëj një pyetje nëse ka mundësi. Unë kam propozuar 12 amendamente që e përmirësojnë ligjin. A ka mundësi dikush të na e thotë një fjalë prej Vetëvendosjes, deputetëve ose ministres, pse se përkrahni asnjë amendament?

Të mos lëshoni fjalë prej vendit. Nëse ka dikush për të thënë diçka, ndizeni mikrofonit, të mos flasësh ashtu se në Kuvend je. Lëshojë mikrofonin të dëgjojmë çfarë po flet. Je duke folur para...

KRYETARJA: Për besë, me zor s’mund ta detyrojmë askënd as të flas as të mos flasë. Vazhdojmë. Pra, jemi te amendamenti 16, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

51 deputetë kanë votuar kundër, 16 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon ky amendament.

Vazhdojmë me amendamentin 17, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

51 deputetë kanë votuar kundër, 19 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon amendamenti 17.

Vazhdojmë me amendamentin 18, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim, Votojmë tash!

52 deputetë kanë votuar kundër, 19 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Për sqarim! Sa herë që e numëroj edhe një votë, është e deputetes Ganimete Musliu. Kjo për hir të opinionit publik që ka probleme me kartelën. Pra, nuk kalon ky amendament.

Vazhdojmë me amendamentin 19, që është propozuar po ashtu nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

51 deputetë kanë votuar kundër, 18 deputetë kanë votuar për, asnjë abstenim. Nuk kalon amendamenti 19.

Vazhdojmë me amendamentin 20, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim, Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar për, një kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 20.

Vazhdojmë me amendamentin 21, që është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Me 62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, kalon amendamenti 21.

Vazhdojmë me amendamentin 22, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda, por me përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Pra, është një amendament që e ka përkrahjen e komisionit.

Prandaj, nëse nuk ka të paraqitur për fjalë. Edhe një herë, nga Përparim Gruda, me përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues, përgatitemi për votim, Votojmë tash!

77 deputetë kanë votuar pro këtij amendamenti, 1 kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 22.

Amendamenti 23 është propozuar nga komisioni përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 23.

Dhe, i fundit, që është amendamenti 24, që është propozuar nga deputeti Përparim Gruda pa përkrahjen e komisionit përgjegjës raportues. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

50 deputetë kanë votuar kundër, 17 deputetë kanë votuar për, një abstenim. Nuk kalon amendamenti 24.

Procedojmë me votimin e Projektligjit nr. 11/L-006 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, me amendamentet e miratuara. Prandaj, lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votimin e projektligjit me amendamentet e miratuara. Votojmë tash! Faleminderit!

Atëherë, me 66 vota për, asnjë kundër, 7 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 11/L-006 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme. Faleminderit shumë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për votimin e këtij ligji!

6. Votimi i Propozimit të GP Lista serbe për emërimin e deputetëve në komisionet parlamentare.

E kemi pasur një pikë të rendit të ditës që ka të bëjë me komisionet, emërimin e anëtarëve të Grupit Parlamentar të Listës serbe për anëtarë në komisionet e Kuvendit, por më herët u njoftova që të shtyhet në një seancë tjetër për shkak të disa ndryshimeve që do të bëhen në këtë drejtim.

E kemi edhe një pikë tjetër të rendit të ditës, që është komisioni hetimor.

7. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar

Prandaj, po vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Pika që e përfshimë sot në agjendën tonë, që është emërimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për veprimet dhe mosveprimet e institucioneve lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje. Vazhdojmë. Ju lutem, zonja Nagavci, urdhëroni, merreni fjalën!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!
Atëherë, në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Hetim Parlamentar dhe neneve 44 dhe 46 të Rregullores së Kuvendit, propozojmë themelimin e

një komisioni hetimor parlamentar me 11 anëtarë dhe mandat maksimum gjashtë muaj nga dita e miratimit të vendimit.

Kërkojmë që Kuvendi të hetojë përmbushjen e detyrimeve institucionale për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së Arlinda Zekajt, si dhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin, mbrojtjen dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje. Objekti, periudha e hetimit dhe detyrat e komisionit janë përcaktuar në propozim-vendimin e bashkëlidhur dhe propozojmë që kjo nismë të procedohet me përparësi, të shqyrtohet, domethënë, të fillojë punën komisioni menjëherë në pajtim me procedurat përkatëse parlamentare. Propozimet konkrete, arsyetimi dhe detaje e tjera janë në dokumentin të cilin e kemi proceduar formalisht dhe i cili u është shpërndarë deputetëve tashmë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Urani Ismaili nga PDK, urdhëro!

URAN ISMAILI: Faleminderit!
Atëherë, po i jap disa vërejtje sa u përket institucioneve dhe marrjes së provave. Mendoj që është e rëndësishme t'i them, e pastaj po flas pak edhe sa i përket qëllimit në institucionet dhe marrjen e provave, institucione ka të ndryshme, mirëpo nuk është e përmendur fare Qeveria!

E dimë që ka një Koordinatore Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në bazë gjinore, dhe është e çuditshme qysh Kuvendi dëshiron të mbikëqyrë punën e këshillit, ose më fal, të shikojë punën e Këshillit Prokurorial, Këshillit Gjyqësor, mirëpo në anën tjetër nuk merret fare me Qeverinë e vet. Kështu që, mendoj se duhet ta dinë qytetarët që ka ministër të Drejtësisë, ka koordinatore që është në këtë rol. Po ashtu, ka strategji nga viti 2022, më duket e miratuar herën e fundit në Qeverinë e Republikës së Kosovës, pra që e bën objekt të mbikëqyrjes të këtij Kuvendi atë strategji se a ka funksionuar apo jo.

Kur thuhet në strategji, thuhet se duhet të ulen rastet, e në realitet rastet janë rritur gjatë kohës që ka pasur strategji. Dhe në qoftë se ka strategji e cila ka dështuar, dhe ka një koordinatore që është e emëruar nga Qeveria, nuk është fare këtu në objekt të hetimit nga ana e Kuvendit. Kështu që, mendoj se dy-tri institucione duhet të shtohen, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe institucione të tjera qeveritare që janë relevante në angazhimin tonë si komision.

Sepse, ja po e marr një shembull, këtu thotë mandej, komisioni respekton ndarjen e pushteteve, pavarësinë e gjyqësorit dhe të prokurorisë, prezumimin e pafajësisë, të drejtat e personave të përfshirë, ai nuk përcakton fajësi penale, nuk rishqyrton themelimin e vendimeve gjyqësore dhe nuk pengon procedurat zhvillimore. Me një fjalë, çfarë bëjmë ne në fund? Pra, unë e kam edhe këtë problem me qëllimin e kësaj. Nëse e them të drejtën, ky komision, fakti që i ka gjashtë muaj ditë, gjashtë muaj ditë të merret me këtë punë në një situatë ku Arlinda i ka paraqitur faktet vetë,

i ka vendosur faktet, faktet i kemi para vetit, dhe të vijmë në një situatë ku faktet janë, e komisioni bëhet për një qëllim gjashtëmujor, për mua nuk e ka qëllimin në angazhimin e vërtetë që t'i dalë deri në fund.

Angazhimi i vërtetë do të ishte sikur të kishte shkarkime! Angazhimi i vërtetë do të ishte sikur t'i lironim nga detyra! Angazhimi i vërtetë nuk duhet të jetë për një Kuvend, i cili i merr edhe gjashtë muaj ditë për të prodhuar një situatë, një komision, më fal, për ta prodhuar një dokument të ri, i cili çka bën? Hedh hi syve, ul temperaturën, e cila është e krijuar në shoqëri sot për rastet e Arlindës dhe raste të tilla të cilat kanë ndodhur.

A e dini sa është numri i grave të cilat janë paraqitur. Janë 27 raste të dhunës ndaj grave brenda tri ditëve në Kosovë. 27 raste! Ne po formojmë, po propozojmë ta formojmë një komision që ka punë edhe gjashtë muaj ditë. Shikoni! Faktet janë, i ka lënë e ndjera, faktet, fatkeqësisht i ka lënë faktet.

Prandaj, mendoj që duhet të jemi të qartë që ky komision nuk e amniston askënd! Ky komision nuk krijon një tajming gjashtëmujor. Ky komision nuk është duke i thënë Arlindës: "Po presim ne edhe gjashtë muaj derisa të merremi me këtë punë". Ky komision mund ta luaj një rol meqë po do Kuvendi ta luajtur një rol, mirëpo roli këtu është i udhëheqësve politikë të cilët kanë pasur strategji, e kanë miratuar në Qeveri, ka koordinatore për atë punë, ka dështuar në atë punë, dhe përgjegjësia duhet me u marrë! Nuk ka nevojë t'i hidhet Kuvendit përgjegjësia, kur institucionet dihet që kanë dështuar njëra pas tjetrës.

Kështu që ju lutem, në qoftë se doni të paktën me bë pak punë, futeni këtu brenda institucioneve dhe marrjen e provave, ato që ne duhet t'i marrim parasysh, që është Qeveria e Republikës së Kosovës. Nuk është Këshilli Prokurorial e Këshilli Gjyqësor që të merren deputetët tash, kur një nen më poshtë thotë, duhet respektuar pavarësinë e tyre.

Prandaj ju kisha lutur, kushdo që është sponsorues, e para, po ju them në aspektin e... Sepse shikoni! Nuk po dua ta akuzoj kurrkënd, duke thënë që vrasja e Arlindës nuk ju ka prekur të gjithëve, nuk na ka prekur të gjithëve. Në asnjë moment nuk jam duke e bërë një gjë të tillë. Çka po kërkoj është që të mos krijojmë, si të them, të mos e vrasim për së dyti ne, duke krijuar këtu komisione nga gjashtë muaj ditë. Të mos e vrasim për së dyti!

Në qoftë se duam me u marrë përnjëmend, ne duhet të merremi përnjëmend me Qeverinë, të merremi me ata që e kanë pasur rolin politik e institucional për t'u marrë me këtë punë.

Ju kisha lutur që t'i merrni me seriozitet juve që e keni propozuar, si vërejtjet tona, ashtu edhe vërejtjen, e cila po bëhet çdo ditë prej qytetarëve, që nuk janë institucionet duke u marrë me

rastet e dhunës, edhe sot po shihet numri i lartë gjatë tri ditëve të fundit, dhe sot e kemi ministren apo dikë tjetër që nuk e lëshon asnjë fjalë për atë punë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Ardian Gola.)

KRYESUESI: Nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, shefja e Grupit Parlamentar, zonja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, nënkryetar!
Për informatë të deputetit, ne e kemi dorëzuar kërkesën për komision hetimor parlamentar me datën 26, pra tri ditë më herët. Për këtë kemi vendosur bashkërisht në seancën e jashtëzakonshme që e mbajtëm me datën 26, për komisionin hetimor parlamentar. Përtej kësaj, kërkesën që e kemi dorëzuar e kemi paraqitur me 40 nënshkrime, sepse kjo është e paraparë me Rregulloret dhe me legjislacionin në fuqi. Dhe në kërkesën që e kemi paraqitur, kemi adresuar çështjet që janë në mandat të këtij Kuvendi të diskutohen e të trajtohen.

Përkundër diskutimeve që mund të bëhen për qëllime të ndryshme, sepse dhe unë nuk dua të paragjykoj për qëllimet që flasin, Kuvendi udhëhiqet nga legjislacioni që ia përcakton saktë dhe qartë mandatin. Përtej fjalimeve që ne mund t'i mbajmë këtu, është mekanizmi i komisionit hetimor parlamentar që mundëson që kjo çështje të trajtohet në detaje, dhe kërkesës që e kemi paraqitur me 40 nënshkrime i qëndrojmë pas.

Nuk është mirë të përhapen të pavërteta që ky komision duhet patjetër të ketë mandatin gjashtë muaj. Këtë e përcakton Ligji për hetimin parlamentar. Sipas ligjit maksimumi i punës së komisionit është gjashtë muaj, ndërkohë që komisioni duhet dhe mund të veprojë me efikasitet në kohën sa më të shkurtër të mundur. Dhe unë këtë e thashë edhe në fjalën time, dhe inkurajoj të gjithë deputetët të cilët do të jenë pjesë e këtij komisioni hetimor parlamentar që të punojnë me efikasitet, me ndershmëri, edhe përtej diskutimeve të cilat nuk çojnë në zbardhjen e përgjegjësve për veprim ose mosveprim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.)

KRYETARJA: Faleminderit! Me radhë është deputetja... Replikë? Urdhëro, replikë!

URAN ISMAILI: Faleminderit!
Zonja Nagavci, as unë, e as asnjëri nuk ishim kundër, mirëpo janë dy gjëra të cilat është e rëndësishme t'i them. E para, komisioni i Kuvendit paraqet raport të përkohshëm brenda 60 ditëve, domethënë, që tregon se ka një tendencë, sipas meje, ka një tendencë të një zvarritjeje në një situatë që kërkon përgjegjësi menjëherë! E lexova drejt!

E dyta, nuk po e kuptoj qysh në institucionet dhe marrjen e provave nuk e kemi futur Koordinatoren Kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave. Dhe ju kisha lutur që ta fusni! Në të kundërtën, po dukeni se po e mbroni Qeverinë! Domethënë, këtë të mos e bëni, sepse ne bashkërisht po e bëjmë. Domethënë, vendosni personat përgjegjës. Nuk po themi që janë fajtorë, mirëpo vendosni personat që kanë obligim institucional ndaj kësaj situate! Kjo është kërkim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Unë vetë kam qenë pjesë e komisionit, komisioni qysh në fillim e bën planin e veprimit, planin e punës me emra të përveçëm të zyrtarëve, qoftë nga politika, qoftë nga institucione të tjera, që ftohen për intervistim. Kështu e mbaj mend që e kemi bërë për çështjen e Telekomit, me sa mbaj mend, dhe unë nuk po shoh se pse ka problem në këtë drejtim.

Vendos komisioni kush janë personat që duhet të ftohen në qoftë se prokurorja e rastit thotë se unë s'e kam pas këtë përgjegjësi, e shohim a e ka paraparë strategjia, e shohim koordinatorja, ish-koordinatorja, sepse besoj që edhe unë duhet të merrem me këtë pjesë. Unë mendoj që nuk ka diçka të keqe, edhe kjo është mënyra se si funksionojnë komisionet hetimore. Ministre, urdhëro nëse dëshironi fjalën, natyrisht! Po!

ZËVENDËSKRYEMINISTRA DONIKA GËRVALLA-SCHWARZ: Shumë të nderuar deputetë,
Themelimi i këtij komisioni është një veprim i cili mbështetet fuqishëm nga ana ime si Koordinatore dhe nga zyra të cilën e udhëheq, dhe absolutisht nuk dua të ketë dilemë as edhe një deputet rreth jo vetëm gatishmërisë, po këtë e kam theksuar edhe në fjalën time në seancën e kaluar, që do të jem plotësisht së bashku me institucionin që drejtoj, në disponimin tuaj për të dhënë përgjigjet e kërkuara dhe për të ndihmuar në zbardhjen e të gjitha fakteve që i posedoj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, ministre! Ka deputetë të cilët janë paraqitur për fjalë. Po vazhdojmë me ta. Kështu që, është deputeti Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Kryetare, unë e kërkova fjalën! A do të shkojmë me mbështetje edhe në votim, edhe ta japim emrin? A është kjo arsyeja, apo duhet të flasim për përmbajtjen? Se s'po e kuptoj! Ne përmbajtjen e kemi marrë, jemi dakorduar ta themelojmë. Tash veç e dimë, a kemi debat për përmbajtjen e dokumentit, apo për... Urdhëro! Po le ta fusë, po. Çka të keqe që të futet një fjali që e ka dhënë Urani. Futeni bre ta kryejmë e ta votojmë.

Haj medet haj kuku! Po çka ka problem një fjali me shti të Uranit, çka ka problem? Atëherë, fute fjalën e ta hedhim në votim e ta kryejmë. Këtë po e them unë. Kjo është kërkesa ime, Arbërie.

Vendoseni fjalinë e Uranit në votim si amendament, e vendosim, e votojmë, i hedhim emrat edhe ecim! Kaq e thjeshtë është kjo punë.

KRYETARJA: Kërkesa jonë është në përputhje me kërkesën për formimin e komisionit hetimor me 40 nënshkrime, pra jo ajo forma tjetër me 6, e qysh e parasheh ligji për hetimet parlamentare. Pra, me 40 nënshkrime. Sot këtu kërkohen emrat. Unë në titull po e shoh "Kërkesë për themelimin e komisionit hetimor për veprimet dhe mosveprimet institucionale". Nuk po thotë këtu vetëm veprimet e mosveprimet e policisë, a prokurorisë, a sistemit të drejtësisë, a sistemit gjyqësor. "Veprimet institucionale" është titulli i këtij komisioni. Prandaj, mendoj që është koha t'i propozoni emrat për këtë komision.

Ju lutem, të mos e shndërrojmë këtë seancë sikur seancën e para disa ditëve! Le ta bëjmë betejën për tema të tjera, por edhe punën profesionale në komision hetimor. Ju lutem! Blerta Deliu, urdhëro!

BLERTA DELIU-KODRA: Zonja kryetare,
E para, unë nuk po shoh që këtu ka dikush që është kundër një komisioni hetimor parlamentar, por një gjë duhet të thuhet me saktësi. Nëse po themelojmë një komision hetimor parlamentar që brenda 60 ditëve do të kthejë përgjigje, dhe ne e kemi këtu në seancë plenare zonjën ministre, zonjën Gërvalla, që në vitin 2022 ka miratuar një Strategji qeveritare 131 faqe, e që ka marrë dakordime, zotime, ka marrë si kryekoordinatore që deri në vitin 2026 numri i vrasjeve të grave në Republikën e Kosovës do të zbritet në 100%.

Pra, aty thuhet saktësisht, dhe më lejoni t'ju lexoj: "Qeveria ka thënë se vetë në strategjinë qeveritare e merr përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rasteve të dhunës ndaj grave".

Tash, zonja ministre sot doli krejt lehtësisht na tha që e mbështet komisionin. Po, zonjë, na trego pse keni dështuar ju si kryekoordinatore për eliminimin e dhunës ndaj grave, para se të flisni për një komision hetimor parlamentar që për 60 ditë do ta bëjë një punë këtu? Tregona njëherë ku është dështimi i një dokumenti që e keni votuar ju, zonja Gërvalla! Vetë keni marrë përgjegjësi. Të gjithë këtu kemi dhimbje për rastin e Arlindës, po përgjegjësisë nuk guxojmë t'i ikim asnjëri.

Edhe nëse vonohemi për 50 ditë, 60 ditë, duhet të japim përgjegjësi ne si deputetë, ju si ministre që keni marrë përsipër të jeni në krye të koordinimit për të eliminuar dhunën ndaj grave. Është krejtësisht e pafalshme të dilet këtu sot lehtësisht dhe të na thuash që "po e mbështes komisionin hetimor parlamentar". A ke pasur detyrim për ta mbledhur atë komision ndërministror kur ka pasur...? Jo, po, është çështja, zonja kryetare! Është çështja në fjalë, është çështja në fjalë! S'kemi ne kurrgjë kundër komisionit hetimor. Kurrkush s'po e konteston...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Vetëm për sqarim! Nuk është tema e kësaj seance Strategjia për Mbrojtje nga dhuna në familje. Ajo do të trajtohet në komisionin hetimor si pikë e parë, cilat janë rekomandimet që i ka paraparë kjo strategji, që janë mbi 100? Kush ka pasur obligim t'i zbatojë ato rekomandime që nuk i ka zbatuar? Kjo është pikë dhe temë kryesore në komision. Aty do të vijë edhe ministrja, aty do të vijë secili për të cilin ju bini dakord që të ftohet si dëshmitar.

Ai raport në fund shkon në prokurori ose në polici. Kështu kemi vepruar dhe nuk po e kuptoj pse po e shfrytëzoni edhe këtë moment për të bërë sulme të tilla. Ju lutem që të jemi bashkë! Ju lutem që të jemi bashkë në disa tema që janë shumë të ndjeshme! Asnjë diskutim, vetëm emrat. Tash e tutje vetëm emrat! Ky komision udhëhiqet nga opozita.

Prandaj, vetëm emrat, asnjë diskutim tjetër! Zonja Nagavci, urdhëro!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!
Siç e thashë, ka ligj për komisionin hetimor parlamentar, është mirë ta lexojmë përpara se të flasim, për ata që nuk e dinë. Më lejo shkurtimisht të përmend vetëm një nen nga ligji që përcakton...

KRYETARJA: Zonja Nagavci, unë thashë vetëm emrat, asnjë diskutim tjetër!

ARBËRIE NAGAVCI: S'është diskutim.

KRYETARJA: Vetëm emrat! Ju lutem, regjia! Zëvendëskryesuesin dhe katër anëtarë.
Ju lutem, vetëm me emrat, zonja Nagavci. Zëvendëskryesuesin dhe katër anëtarë, asnjë diskutim tjetër!

ENVER HALITI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!
Atëherë, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, si zëvendëskryetar propozohet Adnan Rrustemi, ndërsa anëtarë: Armend Baloku, Arijeta Rexhepi, Osman Musliu dhe Adelina Tërshani. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së i ka dy anëtarë, i LDK-së e ka një anëtar, Lista serbe e ka një anëtar, Aleanca një dhe Grupi Multietnik një. Është e rëndësishme që ta caktojmë se kush është kryesuesi.

Nuk e di nëse keni pasur rastin të konsultoheni opozita ndërmjet vete, duke qenë se komisionin hetimor e udhëheq opozita.

Urdhëro, zoti Tahiri, ju lutem për këtë çështje!

ARIAN TAHIRI: Faleminderit!
Partia Demokratike e Kosovës e mbështet komisionin. Emrat e propozuar që të jenë pjesë përbërëse e komisionit janë: Besa Kabashi-Ramaj dhe Eman Rrahmani. Ndërsa për çështjen e kryesuesit, ne jemi dakorduar që ta udhëheqë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

KRYETARJA: Faleminderit! Po, urdhëro Besian!

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryetare! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare do të jetë zonja Doarsa Kica-Xhelili.

KRYETARJA: Faleminderit! Aleanca. Urdhëro, Besnik!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare. Burim Ramadani do të jetë anëtar i grupit dhe njëherësh do ta kryesojë këtë komision hetimor.

KYRETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me Grupin Multietnik. Më fal, Lista serbe? Urdhëro, Milan Joksimoviq!

MILAN JOKSIMOVIĆ: Poštovani! U ime Poslaničke grupe Srpska lista predlažemo Jovanu Radosavljevića za člana komisije.

KRYETARJA: A mund ta përsëritni, ju lutem, edhe një herë emrin?

MILAN JOKSIMOVIĆ: Jovana Radosavljević.

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me Grupin Multietnik. Artan, urdhëro!

ARTAN ASLLANI: Po, faleminderit kryetare!
Ne mbështetim këtë komision edhe në emër të Grupit Multietnik propozojmë që anëtare të jetë zonja Emiljija Rexhepi.

KRYETARJA: Faleminderit! Atëherë, verifikojmë një herë numrin e deputetëve që i kemi në sallë. Regjia, na mundësoni votimin për prezencë. Votojmë tash!

90 deputetë janë prezentë në këtë seancë. I lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati për votimin e Komisionit Hetimor Parlamentar që ndërlidhet me veprimet dhe mosveprimet institucionale lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje. Votojmë tash!

Konstatoj se me 90 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e themeloi Komisionin Hetimor Parlamentar për veprimet dhe mosveprimet institucionale lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt dhe trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe grave në familje.

Kërkohet nga komisioni hetimor parlamentar që të veprojë në përputhje me Ligjin për hetimin parlamentar dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin përfundimtar në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e themelimit të tij.

Ju faleminderit! Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë